

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5978
E premte, 17 janar 2020
çmimi 0.40 €

Rriten veprat penale
që ndërlidhen me
krimet kibernetike,
korrupsionin dhe fajdet



KRYETARI I LËVIZJES VETËVENDOSJE (LV), ALBIN KURTI, I ËSHTË PËRGGJIGJUR LETRËS SË LIDERIT TË LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (LDK), ISA MUSTAFA

ZBEHET SHPRESA PËR MARRËVESHJEN LV - LDK, VENDI DREJT ZGJEDHJEVE TË REJA

Përpjekja e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për arritjen e një marrëveshje për bashkëqeverisje duket se është zbehur të enjten, pasi lideri i LV-së, Albin Kurti, ka refuzuar kërkesën e LDK-së që kësaj

partie t'i kthehet posti i kryetarit të Kuvendit. Në letërën drejtuar Isa Mustafës, Kurti i ka bërë thirrje LDK-së të heqë dorë nga largimi i Glauk Konjufcës prej kreut të Kuvendit dhe t'i rikthehet tryezës së bisedimeve për

marrëveshje. Ndërkaq lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se letërën e Kurtit nuk e konsideron si përgjigje zyrtare, por i bën thirrje të japë kontribut për formimin e institucioneve të dala nga zgjedhjet e 6 tetorit

SHKËMBIMI I TERRITOREVE BALLAFAQON KRYEMINISTRAT NË GJYKATË

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka paditur për shpifje kryeministrin në detyrë të Kosovës, Ramush Haradinaj, meqë pretendon se Haradinaj ka shpifur ndaj Ramës për deklaratat e tij që i ka dhënë në lidhje me temën e shkëmbimit të territoreve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në rrjetet sociale ky veprim i Ramës kryesisht është kritikuar, në disa raste ai është konsideruar edhe tradhtar



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION



**WILLIAM WALKER
E NDALI SERBINE F. 11**

Nga Ismet SYLEJMANI

**ELEKTRONET E LIRA NËPËR
PËRÇUESIN ELEKTRIK F. 11**

Shkruan: Naim
KRASNIQI, fizikan



AKTUALE

**PARTITË SHQIPTARE TË LUGINËS
BASHKOHEN PËR ZGJEDHJET NË
SERBI F. 2**

**KRU 'PRISHTINA' BËN APEL TE
KOMUNA DHE MMPH-JA TA
MBROJNË BADOÇIN F. 7**

EKONOMI

**PAS PADISË SË LV-SË, GJYKATA
PEZULLOI VENDIMIN E BORDIT
TË ZRRE-së F. 8**

KULTURË

Flet Daut DAUTI

**KRIJIMI I SHQIPËRISË NË
LONDËR SI REZULTAT I NJË
KOMPROMISI TË FUQIVE TË
MËDHA F. 20**



Partitë shqiptare të Luginës bashkohen për zgjedhjet në Serbi

TIRANË, 16 JANAR - Partia për Veprim Demokratik, Alternativa për Ndryshim, Partia Demokratike, Lëvizja Reforma në PDSH dhe Lëvizja e Progresit Demokratik në Luginë të Preshevës, kanë arritur të krijojnë për herë të parë një ujdi ku do të përfaqësohen me një program në zgjedhjet e ardhshme parlamentare të Serbisë. Programi i tyre i përbashkët do të quhet "Alternativa Demokratike Shqiptare - Lugina e Bashkuar"

dhe shënon bashkimin e palëve për të siguruar një përfaqësim sa më të lartë dhe për të krijuar një pozicion sa më të fuqishëm prej zgjedhjeve parlamentare në Serbi.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshje të përbashkët është bërë në Tiranë në mes të përfaqësuesve të partive shqiptare të Luginës dhe në prani të ministrit në detyrë për Punë të Jashtme, Gent Cakaj.

"Ky bashkim do t'i shërbejë jo

vetëm fuqizimit të Luginës së Preshevës, por edhe rritjes së frymëzimit kombëtar të shqiptarëve në përgjithësi. Partitë nënshkruese të kësaj marrëveshje sot kanë dhënë shembullin më të vyer të tejkallimit të dallimeve të brendshme në funksion të Luginës së Preshevës dhe intereseve kombëtare në përgjithësi. Urime të gjithëve, për qafime Luginës së Preshevës dhe shihemi së shpejti", ka shkruar Cakaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Varhelyi: Negociatat me Shqipërinë t'i hapim para samitit të Zagrebit

Komisionari evropian i Zgjerimit, Oliver Varhelyi tha se raporti i mëparshëm i KE-së për Shqipërinë vazhdon të jetë i vlefshëm dhe ne vazhdojmë ta konsiderojmë Shqipërinë si një shtet, i cili është gati për t'i çelur negociatat me BE-në dhe ne do të punojmë fort që kjo të bëhet realitet përpara samitit të Zagrebit

TIRANË, 16 JANAR - Komisioni Evropian synon që hapja e bisedimeve për anëtarësim me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut të mund të arrihet në muajin mars. Komisionari evropian i Zgjerimit, Oliver Varhelyi, tha të enjten në Tiranë se negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut duhet t'i nisim këtë vit, përpara samitit të Zagrebit. Në një konferencë për gazetarë me kryeministrin Edi Rama, komisionari evropian tha se, kjo është ndalesa e dytë në udhëtimin tim të parë jashtë shteteve anëtare të BE-së. "Për mua ka qenë përparësi të vija këtu shumë herët në mandatin tim për të përforcuar mbështetjen tonë për Shqipërinë, por po ashtu për të theksuar në fakt edhe natyrën gjeopolitike të këtij Komisioni të ri. Për ne zgjerimi dhe Ballkani Perëndimor janë prioritet", tha ai. Varhelyi tha se ne dëshirojmë ta

rrisim praninë tonë këtu dhe dëshirojmë të kemi më shumë ndikim, më shumë influencë. "Dëshirojmë të jemi një partner edhe më i rëndësishëm për të gjithë rajonin dhe në lidhje me këtë unë do të punoj me vendosmëri së bashku me ju, kryeministër, në mënyrë që kjo gjë të bëhet realitet", tha komisionari evropian i Zgjerimit. Ai tha se raporti i mëparshëm i KE-së për Shqipërinë vazhdon të jetë i vlefshëm dhe ne vazhdojmë ta konsiderojmë Shqipërinë si një shtet, i cili është gati për t'i çelur negociatat me BE-në dhe ne do të punojmë fort që kjo të bëhet realitet përpara samitit të Zagrebit. Varhelyi sqaroi se, Komisioni do të ketë një sërë propozimesh të reja në tri drejtime, apo shtylla kryesore. E para, do të bëhet e qartë në fakt edhe këtë muaj dhe do të jetë një metodologji e re në lidhje me trajtimin e negociatave për anëtarësimin në BE.



"Ne duhet të kuptojmë një gjë. Fakti që nuk u hapën negociatat në tetor ka pasur të bëjë me shqetësime nga disa shtete anëtare dhe duhet të shikojmë këtë gjë dhe këto shqetësime me vëmendje. Ne në fakt po punojmë me miqtë tanë këtu, por po ashtu dhe me shtet anëtare, në mënyrë që të gjejmë një zgjidhje, e cila do të krijojë një mundësi të re për ne, një shans të ri, që të ecim përpara me procesin e zgjerimit", tha komisionari

Varhelyi. "Me këtë metodologji ne përpiqemi që të krijojmë një qasje të re, e cila do të bazohet në katër parime, të cilat do të duhet që të funksionojnë jo vetëm në vendet që dëshirojnë të anëtarësohen në BE, por edhe për shtetet anëtare", tha ai. Ai tha se procesi do të duhet të jetë më i besueshëm, do duhet të jetë edhe më politik. Po ashtu do të duhet që të jetë më i parashikueshëm dhe për mua

është përparësi që ta bëjmë atë edhe më dinamik. Kështu që ne po përpilojmë tashmë një propozim, i cili do t'i marrë parasysh të gjitha këto gjëra. "Shtylla e dytë për mua është që ne të kemi mundësinë që t'i fillojmë negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, këtë vit përpara samitit të Zagrebit. Po punojmë për këtë çështje edhe me kryeministrin, por edhe me shtetet anëtare", tha Varhelyi.

Palmer takon ambasadorin e re në Tiranë Yuri Kim

Tiranë, 16 janar - Yuri Kim e ka bërë tashmë betimin si ambasadore e ShBA-së në Tiranë dhe pritet që të mbërrijë në Shqipëri në ditët në vijim. Ndërkohë, ambasadorja Kim ka zhvilluar së fundmi një takim me Matthew Palmer, zëvendës ndihmës sekretari amerikan i Shtetit dhe i dërguari i veçantë për Ballkanin Perëndimor, me të cilin

ka diskutuar qëndrimet e Shqipërisë ndaj Iranit, si dhe dialogun e nisur për reformën zgjedhore. "Zëvendës ndihmës sekretari amerikan i Shtetit dhe i dërguari i veçantë për Ballkanin Perëndimor Matthew Palmer u takua me ambasadorin Yuri Kim për të diskutuar qëndrimin e guximshëm dhe parimor të

Shqipërisë mbi Iranin, si dhe lajmin pozitiv lidhur me përkushtimin ndërpartiak për të realizuar reformën zgjedhore në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR", thuhet në reagimin e Ambasadës së SHBA-së në Tiranë. "ShBA-ja qëndron krah Shqipërisë", thuhet në reagimin e Ambasadës së SHBA-së në Tiranë.



Shkëmbimi i territoreve ballafaqon kryeministrat në gjykatë



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka paditur për shpifje kryeministrin në detyrë të Kosovës, Ramush Haradinaj, meqë pretendon se Haradinaj ka shpifur ndaj Ramës për deklaratat e tij që i ka dhënë në lidhje me temën e shkëmbimit të territoreve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në rrjetet sociale ky veprim i Ramës kryesisht është kritikuar, në disa raste është konsideruar edhe tradhtar

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 16 JANAR - Gjykata Themelore në Prishtinë ka konfirmuar se kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, ka dorëzuar padi kundër kryeministrin në detyrë të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, lidhur me akuzat rreth shkëmbimit të territoreve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se sipas ligjit do të për-

gatisë përgjigje ndaj padisë së Ramës. Haradinaj ka thënë se padia e Ramës është plotësisht e pabazuar. "Unë, sipas ligjit, do të përgatis përgjigje në padi, në afatet e përcaktuara ligjore. Padia e kryeministrin Rama është plotësisht e pabazuar dhe një diversion politik që bëhet nga ana e tij, që të fshihet pas dramave mediale dhe t'i ikë përgjegjësisë. Kombi ynë dhe Kosova ka njerëz që i dalin zot në çdo kohë", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ky veprim i Ramës për padi ndaj Haradinajt ka ngjallur reagime në Shqipëri dhe Kosovë.

Nëpër rrjetet sociale ky veprim i Ramës kryesisht është kritikuar, në disa raste ai është konsideruar edhe tradhtar. Kryetari i Partisë Demokratike (PD), Lulzim Basha, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se ky veprim i Ramës është turp i pakapërdishëm. Basha ka thënë se ky akt i ulët që na turpëron të gjithëve meriton

refuzimin dhe revoltën legjitime ndaj një kryeministri të dështuar fund e krye dhe ndaj falimentimit të tij politik dhe moral para Shqipërisë dhe mbarë kombit shqiptar. "Pseudo-padia e Edi Ramës ndaj kryeministrin të Kosovës është një perversitet i shëmtuar antikombëtar. Është turp i pakapërdishëm që Ramush Haradinaj, pas gjakut të tij dhe familjes së tij për çlirimin e Kosovës, pas betejave me akuzat e montuara të Beogradit, të përballet me

pasojat e degjenerimit dhe vasalitetit të Edi Ramës. Ky akt i ulët që na turpëron të gjithëve meriton refuzimin dhe revoltën legjitime ndaj një kryeministri të dështuar fund e krye dhe ndaj falimentimit të tij politik dhe moral para Shqipërisë dhe mbarë kombit shqiptar", ka shkruar Basha.?

Edhe kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, ka reaguar pas padisë së depozituar nga kryeministri Edi Rama për kryeministrin në detyrë të Kosovës, Ramush Haradinaj. "Shqipëria është në një rrezikshmëri të lartë, sepse me Edi Ramën ajo rrezikohet çdo ditë e më shumë. Rreziku i gjithë kësaj situatë negative, në kuadrin e shpopullimit, po edhe në kuadrin e rënies ekonomike të shkatërrimit të të gjithë sistemit, jo vetëm politik, po edhe shoqëror, ka vetëm një emër dhe është Edi Rama. Mjafton të shikojmë se çfarë ndodhi dje, ditën e përkujtimit të viktimit të masakrës së Reçakut, Edi Rama gjeti momentin për ta paditur luftëtarin e UÇK-së, vëllanë e dëshmorëve që çliruan Kosovën me gjakun e tyre, në gjykatë. Ky është Edi Rama! Mendoni se çfarë bën në një moment të tillë dhe mendoni se çfarë mund t'u bëjë akoma më shumë shqiptarëve", ka thënë Monika Kryemadhi.

Edhe ish-ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, ka reaguar ndaj veprimit të Ramës. Hasani përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se është tepër i turpshëm ky veprim i Edi Ramës për padi ndaj kryeministrin Ramush Haradinaj. "Tepër i turpshëm veprimi i Edi Ramës. Pastaj ta mendosh se në çfarë dite erdhi kjo padi", ka shkruar Hasani.

KRU "Prishtina" bën apel te komuna dhe MMPH-ja ta mbrojnë Badocin

PRISHTINË, 16 JANAR (ER) - Bordi i drejtorëve i Ujësjetës të Prishtinës, bashkë me kryeshefin ekzekutiv Ilir Abdullahu dhe sekretarin e kompanisë Salih Gjonbalaj, ishin të enjten për vizitë te liqeni i Badocit. Ata apeluan edhe tek institucionet, Komuna e Prishtinës dhe Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, që të kenë kujdes për mbrojtjen dhe ruajtjen e këtij resursi ujor jetik për qytetarët.

Sipas njoftimit nga KRU "Prishtina", liqeni i Badocit është një liqe akumulues sipërfaqësor

nga i cili furnizohen me ujë të pijshëm 30 për qind e konsumatorëve në zonën operative, Graçanica, Çagllavica, Hajvalia, Veterniku, Miradia e Epërme, një pjesë e Prishtinës si: Mati I, Bregu i Diellit, Kolovica, Sofalia, Toukbashqë dhe Zllatari. "Vizita e tyre sot kishte të bënte me njohjen më për së afërmi të rënies së nivelit të ujit në këtë liqe, mbi 10 metra nga kuota maksimale dhe mundësitë më të mira për menaxhimin e situatës nëse situata aktuale përcillet edhe më tej me thatësira mbi vendin tonë", thuhet në njoftimin

dërguar mediale.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve Betim Berisha, duke ritheksuar rëndësinë dhe vlerat e pamohueshme të liqenit të Badocit, për një pjesë të konsiderueshme të konsumatorëve në zonën shërbyese operative tha se uji është burim natyror shumë i nevojshëm për ekonomi dhe mirëqenien sociale. Sipas tij, të gjithë janë përdorues të ujit të pijshëm, andaj në të njëjtën kohë duhet përgjegjësi për ruajtjen dhe mbrojtjen e burimeve ujore dhe se këto akumulacione varen nga reshjet atmosferike.



Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, i është përgjigjur letrës së liderit të Lidhjes Demokratike të Kosovës

Zbehet shpresa për marrëveshjen LV



Përpjekja e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për arritjen e një marrëveshje për bashkëqeverisje duket se është zbehur të enjten, pasi lideri i LV-së, Albin Kurti, ka refuzuar kërkesën e LDK-së që kësaj partie t'i kthehet posti i kryetarit të Kuvendit. Në letrën drejtuar Isa Mustafës, Kurti i ka bërë thirrje LDK-së të heqë dorë nga largimi i Glauk Konjufcës prej kreut të Kuvendit dhe t'i rikthehet tryezës së bisedimeve për marrëveshje. Ndërkaq lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se letrën e Kurtit nuk e konsideron si përgjigje zyrtare, por i bën thirrje të japë kontribut për formimin e institucioneve të dala nga zgjedhjet e 6 tetorit

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË 16 JANAR - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, ka refuzuar të enjten ofertën e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për bashkëqeverisje. Përmes një letrë Kurti ka ftuar liderin e LDK-së, Isa Mustafë, që të heqë dorë nga kërkesa për largimin e kryetarit të ri të Kuvendit, Glauk Konjufca. Kurti e ka ftuar Mustafën që t'u kthehet bisedimeve për marrëveshjen. "Është për të ardhur keq që keni vendosur t'i ndërprisni takimet tona për koalicionin qeverisës duke më detyruar të shkruaj letra, thuajse jemi kundërshtarë politikë apo jetojmë në kontinente të ndryshme", ka shkruar Kurti në letrën drejtuar Mustafës.

Ai ka vlerësuar se deri më tani

LV-ja është treguar mjaft bujare me LDK-në. "Bujarisht ju kemi ofruar më shumë se gjysmën e Qeverisë (raportin 6:5 të ministrive) juve si parti që keni dalë e dyta në zgjedhje. E kemi pranuar edhe çështjen e zgjedhjes së presidentit e cila nuk është fare urgjente dhe për të cilën nuk kemi garuar. U treguam më shumë se të gatshëm ta rrisim pjesëmarrjen e LDK-së në qeverisje, në pushtet. Mirëpo, nuk mund tash t'i delegjitojmë institucionet demokratike me ujdi monarkësh. Zgjedhja e z. Konjufca ishte legale dhe legjitime", ka shkruar Kurti.

Më tej, ai ka vlerësuar se nuk mund të kthehen para 26 dhjetorit, kur LDK-ja ka refuzuar ofertën e tij për kryeparlamentar të LDK-së. Sipas Kurtit, LDK-ja ka të drejtë ta ndërmarrë iniciativën për shkarkimin e kryetarit

të ri të Kuvendit, por LV-ja nuk do t'i ndihmojë në këtë drejtim. "Ju keni të drejtë të jeni të penduar dhe të kërkonit nga grupi parlamentar i LDK-së që, po ashtu, të pendohet dhe ta ndërmarrë iniciativën ta shkarkojë kryetarin e ri legjitim e demokratik të Kuvendit të Kosovës, z. Glauk Konjufca. Kishte dhjetëra vota kundër z. Konjufca më 26 dhjetor 2019. Pra, përveçse keni të drejtë, ju keni edhe gjasa ta shkarkoni z. Konjufca. Pra, unë nuk mund t'ju ndihmoj në këtë rrugë", ka shkruar Kurti.

Pasi ka pranuar këtë lideri, kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, u është adresuar mediave, duke thënë se ajo nuk është një përgjigje zyrtare. Ai ka thënë se LDK-ja është e interesuar që të ketë një marrëveshje për bashkëqeveris-

Konjufca thërret mbledhjen e parë të Kryesisë së Kuvendit



PRISHTINË, 16 JANAR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, ka thirrur për të hënë, më 20 janar 2020, mbledhjen e parë të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, të Legjislaturës VII. Sipas njoftimit të Kuvendit,

mbledhja do të mbahet në orën 11:00. "Rendi i ditës: 1. Shqyrtimi i kërkesës për caktimin e delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në Asambleenë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore-SEECP; 2. Shqyrtimi

i kërkesës për caktimin e delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës; dhe shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave", është thënë në njoftimin e Kuvendit të Kosovës.

(LDK), Isa Mustafa

- LDK, vendi drejt zgjedhjeve të reja



je me LV-në. "Letrën do ta shohim, nuk e konsideroj se është letër zyrtare dhe përgjigje zyrtare. Ajo është letër që përbën cilësime të cilat nuk janë shumë zyrtare. Ajo që mund t'ju them është që ne jemi të interesuar ta përfundojmë këtë proces, jemi të interesuar të gjejmë rrugë për marrëveshje, t'i themelojmë institucionet dhe të mos vazhdojmë kjo agoni e institucioneve. Për këtë ne do të përpiqemi të punojmë maksimalisht dhe për këtë kërkoj që edhe LV-ja si partnere e mundshme ta japë kontributin e vet", ka thënë Mustafa. I pyetur për mundësinë e thirrjes së Këshillit të Përgjithshëm të LDK-së për ta shqyrtuar ofertën e LV-së, Mustafa ka thënë se nëse e thirrën mbledhjen e këtij organi ata do t'i diskutojnë çështjet parimore e jo letrën e LV-së. "Nëse e mbajmë këshillin, diskutojmë për çështje që janë parimore, por ne nuk diskutojmë në këshill elemente të letrave të subjekteve të tjera politike. Ne i kemi të përcaktuara parimet e marrëveshjes", ka deklaruar Mustafa.

Edhe anëtari i Kryesisë së LDK-së, Ismet Beqiri, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka reaguar lidhur me refuzimin e ofertës së fundit të LDK-së nga ana e LV-së. Beqiri ka postuar një fotografi të tij,

mbi të cilën ka shkruar: "Bashkëqeverisje e balancuar, as më shumë dhe as më pak".

Analistët: LV-LDK po bëjnë lojë nervash, paralajmërojnë zgjedhje të reja

Njohësit e rrethanave politike në vend kanë shprehur pesimizëm se mund të ndodhë një marrëveshje për bashkëqeverisje në mes të LV-së dhe LDK-së. Analisti politik Astrit Gashi ka vlerësuar se kjo çka po bëjnë këto dy parti është një lojë nervash. "Kushdo që mendon se LDK-ja do të thotë 'jo'-në përfundimtare gabohet rëndë. Në këtë lojë nervash LDK-ja dëshiron ta sjellë punën që sikur 'po'-në ashtu edhe 'jo'-në ta thotë Vetëvendosje. Mundësisht përmes një videoje të Albinit! Të njëjtën gjë me gjasë e dëshiron edhe LV-ja. Të presim dhe të shohim se cilën palë do ta lëshojnë nervat të paren", ka shkruar Gashi në profilin e vet në "Facebook".

Edhe njohësi tjetër i proceseve politike në vend, Vigan Qorrolli, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka paralajmëruar qytetarët e vendit se shpejt do të ketë zgjedhje të reja.

Ai ka thënë se problemet në mes të LV-së dhe LDK-së janë të mëdha, nuk është në pyetje posti i kryetarit të Kuvendit të Kosovës. Po ashtu, situatën e negociatave në mes të LV-së dhe LDK-së e ka komentuar edhe analisti tjetër politik Avni Mazrreku, i cili beson se nuk mund të ketë më një marrëveshje për bashkëqeverisje në mes të LV-së dhe LDK-së.

Ai ka thënë se periudha nga përfundimi i certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të 6 tetorit e deri më tani tregon se edhe nëse do të arrihet marrëveshja për qeverisjen të vendit nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, projektionet programore dhe objektivat e dy subjekteve për procesin e shtetëbërjes mund të dështojnë. Ai ka thënë se për të dalë nga situata aktuale, LV-ja si fitues e zgjedhjeve duhet të propozojë një qeveri kalimtare. "LV-ja do të duhej të propozonte një qeveri kalimtare, e llojit të ekspertëve, por me karakter nacional dhe tematik, për një periudhë 12 deri 18 muaj; Qeveria kalimtare do të duhej të jetë rezultat i një kompromisi gjithëpërfshirës (në këtë qeveri të përfshiheshin të gjitha partitë politike që janë pjesë e Kuvendit të Kosovës); kryeministri i Qeverisë kalimtare do të duhej të ishte kandidati/kandi-

datja e propozuar nga LV-ja; numri i ministrive, përkatësisht reduktimi i ministrive do të duhej të përfshihej në kuadër të reformës së Administratës Publike dhe të vendosej si njëri nga top-prioritetet e qeverisë së re", ka shkruar Mazrreku, duke shtuar se numri i ministrive të ndahej në raport me përqindjen e fituar në zgjedhjet e 6 tetorit 2019. Sipas tij, kjo qeveri do të duhej ta ketë si prioritet reformën në sistemin e drejtësisë, reformën e sistemit zgjedhor, si dhe reformat në administratën publike.

Një ditë më parë edhe Lidhja Demokratike e Kosovës e ka publikuar ofertën e saj për koalicion qeverisës, duke e prezantuar atë si ofertë të fundit. "LDK-ja do të ketë kryetarin e Kuvendit deri në zgjedhjen e presidentit, pastaj kryetari i Kuvendit do t'i kalojë Lëvizjes Vetëvendosje. Kjo nënkupton se në vitin e parë të bashkëqeverisjes secili partner mban një pozitë të lartë shtetërore (Vetëvendosje e ka kryeministrin, LDK-ja kryetarin e kuvendit). Ndërkaq, në tri vitet e tjera, Vetëvendosje mban dy pozita të larta shtetërore (kryeministrin dhe kryetarin e Kuvendit), kurse LDK-ja një pozitë (presidentin, por që shërben

si faktor unifikues sipas Kushtetutës)", është thënë në përmbajtjen e propozimit të LDK-së.

Pika e dytë e ofertës së LDK-së parasheh që të mos ndodhë rritja e numrit të ministrive, siç kishte kërkuar LV-ja. "Numri i ministrive mbetet 12 dhe struktura e tyre mbetet siç është dakorduar më herët, me këto përjashtime: a) Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit i bashkohet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; b) Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ndahet nga Ministria e Punëve të Brendshme, ku është integruar sipas marrëveshjes së arritur në takimet e mëparshme, dhe mbetet për komunitetet joshumicë krahas Ministrisë për Komunitete dhe Kthim", është thënë në ofertën e LDK-së.

Deri më tani liderët e të dy partive, Albin Kurti dhe Isa Mustafa, janë takuar disa herë me synimin për ta përmblytur një marrëveshje për koalicion, mirëpo të gjitha takimet kanë rezultuar të pasuksesshme. Në zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit të vitit të kaluar Lëvizja Vetëvendosje ka dalë partia e parë me 29 deputetë, kurse LDK-ja e dyta me 28 deputetë.



Haradinaj përkujton Skënderbeun

Prishtinë, 16 janar (ER) - Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka kujtuar Gjergj Kastriotin një ditë para përvjetorit të vdekjes së tij. Ai ka thënë se Skënderbeu është gjithmonë frymëzim për shqiptarët duke e quajtur edhe kryprinc të popullit. "Më 17 janar 1468 pushoi së rrahuri zemra e themeltarit të Shqipërisë, kryepriincit të shqip-

tarëve, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Gjenerali që sfidoi superfuqitë e kohës është gjithmonë frymëzim për secilin që ndihet shqiptar. Vepra e tij gjithmonë ndezi shkëndijat e kryengritjeve për liri. Lumë shqiptarët që e kishin! Lavdi e përjetshme!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Përfaqësuesit e tri sindikatave takojnë Konjufcën, shqetësohen për mosmiratimin e buxhetit

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 16 JANAR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, i është përgjigjur kërkesës së SBASHK-ut, FSSHK-së dhe SPK-së për një takim në të cilin kanë shprehur shqetësimet e mijëra të punësuar në këta sektorë nga paralajmërimet se në mungesë eventuale të Ligjit të aprovuar për buxhetin e vitit 2020 gjithë të punësuarit në Kosovë mund të mbesin pa pagat e tyre nga marsi 2020 e tutje.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i FSSHK-së Blerim Sylja dhe kryetarja e SPK-së, Valbona Kamberi, kanë shprehur shqetësimet e tyre në emër të mijëra anëtarëve që përfaqësojnë, duke kujtuar se pas zhgënjimit që ndodhi lidhur me Ligjin e pagave, nëse ndodh që të mos ketë as Ligj të buxhetit dhe procedim të pagave, atëherë situata do të jetë tepër e tensionuar dhe mund të ndodhin edhe veprime e reagime

nga më të ndryshmet sepse, siç thanë ata, shumica e të punësuarve në këta sektorë jetojnë nga paga e tyre dhe do të jenë të paparashikueshme reagimet e tyre nëse mbesin pa paga, aq më keq kur shumica janë edhe në kredi në bankat e ndryshme.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, është shprehur se këtë shqetësim e ka edhe ai dhe se ka shqyrtuar me ekspertë mundësitë eventuale që Kosova ta ketë Ligjin e buxhetit për vitin 2020 për të mos ardhur në situatën e mbetjes pa paga të mijëra të punësuarve në sektorë të ndryshëm, por në situatën aktuale mundësitë për të pasur një Ligj të buxhetit janë të vogla. Ai ka thënë se do të angazhohet që në bashkëpunim me të gjitha palët e tjera të gjejnë një zgjidhje të lejuar ligjrisht. SBASHK-u, FSSHK-ja dhe SPK-ja u kanë bërë thirrje deputetëve dhe subjekteve politike që të angazhohen dhe bashkërisht të gjejnë zgjidhje në mënyrë që marsi mos ta gjejë në bllokim total shtetin.



Në Spitalin e Prizrenit përrurohen pajisje në vlerë 300 mijë euro

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRIZREN, 16 JANAR - Në Spitalin e Përgjithshëm të Prizrenit sot janë përruruar aparatat e reja mjekësore, donacion nga Qeveria e Luksemburgut, në vlerë prej 300 mijë eurosh. Në ceremoninë e mbajtur me këtë rast, drejtori i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Basri Sejdiu, ka falënderuar Qeverinë e Luksemburgut për këto investime. "Pas investimeve të projektit KSV/017 për Programin Mbështetës për Shëndetësinë e Kosovës nga Qeveria e Luksemburgut, vërehen ndryshime pozitive brenda ShSKUK-së, në veçanti në Spitalin e Prizrenit dhe Gjilanit. Falënderojmë Qeverinë e Luksemburgut, Zyrën Regionale dhe udhëheqësit e projektit që investuan në infrastrukturë, pajisje mjekësore dhe konsulencë profesionale dhe segmente të tjera", u shpreh drejtori Sejdiu. Ai ka thënë se shpreson që ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe më tutje, me qëllim të përkrahjes së mëtejme për ShSKUK-në.

Ambasadorja e Qeverisë së Luksemburgut, Natacha Gomes, ka thënë se Qeveria e Luksemburgut ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për realizimin e projekteve në Kosovë si në pajisje dhe funksionalizim të shërbimeve në neonatologji, patologji dhe

ngritje të kapaciteteve humane, menaxheriale dhe profesionale. "Një pikë e rëndësishme janë edhe planet strategjike për Spitalin e Prizrenit dhe Gjilanit, dokumentet informuese, si dhe trajnimi i stafit që kanë mundur ngritjen e kualitetit të shërbimeve dhe mirëqenien e qytetarit. Ne do ta vazhdojmë përkrahjen për institucionet dhe shëndetësinë në Kosovë", ka thënë ambasadorja Gomes.

Në anën tjetër, Afrim Avdaj, drejtor i Spitalit të Përgjithshëm në

Prizren, pasi ka falënderuar donatorët për përkrahje të vazhdueshme, ka shtuar se vlera e pajisjeve të pranuar është mbi 300 mijë euro. "Me këtë përkrahje është rritur gama dhe cilësia e shërbimeve shëndetësore. Besojmë se përkrahja do të vazhdojë edhe në të ardhmen", është shprehur drejtori Avdaj. Në fund të ceremonisë, Spitali i Prizrenit ka ndarë mirënjohje për drejtorin e ShSKUK-së, Ministrinë e Shëndetësisë dhe donatorët nga Qeveria e Luksemburgut.



William Walkeri nderohet me titullin 'Krenaria e kombit shqiptar'

PRISHTINË, 16 JANAR - Dega e Lidhjes së Historianëve të Kosovës "Ali Hadri", në bashkëpunim me Komunën e Deçanit kanë nderuar ish-ambasadorin William Walker me titullin "Krenaria e kombit shqiptar". Selim Lokaj, kryetar nderi i Lidhjes së Historianëve Dega në Deçan, ka thënë se janë të nderuar që i ndajnë këtë titull njeriut që i ndihmoi shumë Kosovës.

Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se Walkeri është shndërruar në figurë të paqes dhe promovues i lirisë në botë. E njeriu që 21 vjet më parë me tri fjalë e tregoi të vërtetën që po ndodhte në Kosovë, ambasadori William Walker, ka theksuar se për këta 21 vjet është mishëruar me popullin e Kosovës. Ai ka pohuar se nuk e ka të lehtë t'i harrojë ngjarjet që ndodhen 21 vjet më parë.

Prezantohet 'Raporti vjetor 2019' i Policisë së Kosovës

Rriten veprat penale që ndërlidhen me krimet kibernetike, korrupsionin dhe fajdet

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, së bashku me zëvendës drejtorin e përgjithshëm dhe drejtorët e departamenteve të PK-së, kanë prezantuar të enjten raportin vjetor të vitit 2019. Qalaj, duke prezantuar raportin, ka thënë se ky ka qenë ndër vitet më të suksesshme të policisë. Megjithatë, sipas këtij raporti, janë rritur veprat penale që ndërlidhen me krimet kibernetike, korrupsionin dhe fajdet

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINE, 16 JANAR - Kosova vitin e kaluar ka pasur më pak vepra penale, vrasje dhe vjedhje. Për këtë arsye, viti 2019 po konsiderohet i suksesshëm për Policinë e Kosovës, edhe pse ka pasur rritje në fushën e krimeve ekonomike, sidomos në aspektin e korrupsionit dhe fajdeve. Kështu u tha në konferencën e Policisë së Kosovës ku u prezantua raporti vjetor i punës. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, duke prezantuar raportin, ka thënë se ky ka qenë ndër vitet më të suksesshme të policisë. "Ka qenë një vit i suksesshëm, kemi bërë një punë mjaft të madhe për parandalimin e veprave penale, kemi ofruar siguri për të gjithë qytetarëve, kemi pasur një mori sfidash të cilat i kemi kaluar.

Konsideroj se ato sfida janë realizuar mjaft mirë edhe në bashkëpunim me institucionet e tjera. Kemi arritur që ta zvogëlojmë krimin, sidomos në fushën e veprave penale, kemi arritur që të merremi me shumë hetime mjaft komplekse të veprave penale të ndryshme qoftë në fushën e terrorizmit, apo të krimeve të rënda. Kemi arritur që të organizojmë një numër të madh të trajnimeve në vend e jashtë, qoftë sjelljen e ekspertëve të ndryshëm nga institucionet e huaja. Kemi arritur që vitin e kaluar t'i kemi dy gjenerata të Akademive, kemi arritur që ta shfrytëzojmë buxhetin maksimalisht në fushën e shërbimeve rrjedhëse, për blerjen e një numri të rëndësishëm të pajisjeve të PK-së dhe, po ashtu, kemi arritur që Zyrën e Mediave ta mbështesim dhe që të kemi bashkëpunim me

media", ka thënë ai.

Për detajet e numrit të rasteve ka folur drejtori i Departamentit për Operacione, Afrim Ahmeti. Ai ka thënë se krahasuar me vitin 2018, ka pasur ulje të tyre në rreth 8.90 për qind. "Gjatë vitit 2019 në Divizionin për Siguri Publike janë evidentuar 43 668 raste, prej tyre 30 259 mijë vepra penale dhe 13 409 raste të natyrave të tjera. Krahasuar me vitin 2018 ka pasur ulje të rasteve për 8.90 për qind. Ulje të veprave penale për 15.73 për qind. Raste të vrasjeve në vitin 2018 kemi pasur 34, ndërsa në vitin 2019, 23 raste, apo ulje për 32 për qind. Lëndime të rënda trupore kemi

pasur 288 raste në vitin 2018, 265 raste kanë qenë në vitin 2019. Kurse raste të vjedhjeve kanë qenë 5 842 në vitin 2018, ndërsa në vitin 2019, 4 519 raste, apo një ulje për 22,64 për qind. Vjedhje të rënda, 4 474 raste në vitin 2018, ndërsa në vitin 2019 3 803 raste, apo një ulje prej 20.33 përqindësh. Te grabitjet, gjithashtu, ka pasur një rënie nga 297 raste që janë shënuar në vitin 2018, 171 raste kanë ndodhur në vitin 2019, apo një ulje për 42.42 për qind. Rastet e dhunës në familje nga 1 540 nga viti 2018, në vitin 2019 me 1 914 raste apo një ngritje për 24.4 për qind. Këto raste ne i marrim jo si rritje të rasteve të dhunës në

familje, po si besim i qytetarëve për raportim në polici", ka thënë ai.

Ndërsa drejtori i Departamentit të Hetimeve, Riza Shillova, ka bërë me dije se ka pasur rritje të veprave penale që ndërlidhen me krimet kibernetike, korrupsionin dhe fajdet. Si sukses të këtij departamenti ai tha se është angazhimi për konfiskimin e narkotikëve dhe luftës kundër terrorizmit. "Kemi rritje të aktiviteteve të disa veprave penale që ndërlidhen me krimet kibernetike, korrupsionin dhe fajdet. Do të thotë këto janë në rritje, ndërsa në përgjithësi në veprat e tjera penale kemi rënie", është shprehur Shillova.

Gjyqtarët njoftohen rreth platformës për të drejtat e njeriut

PRISHTINE, 16 JANAR (ER) - Institucioni i Avokatit të Popullit ka mbajtur një sesion informues të enjten para gjyqtarëve mbi përdorimin e Platformës për të Drejtat e Njeriut dhe Objektive për Zhvillim të Qëndrueshëm. Platforma online ka për qëllim promovimin e zbatimit të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, siç garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me aktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe me ligjet e zbatuara në Republikën e Kosovës dhe, si e tillë, do t'u shërbejë edhe gjyqtarëve të Republikës së Kosovës në punën e tyre. Gjyqtarët dhe stafi tjetër profesional i gjykatave theksuan se platforma del të jetë një mjet i dobishëm për punën e tyre. Platforma ofron informacion të



dobishëm për të gjitha subjektet e ligjit, përfshirë qytetarët, organet e zbatimit të ligjit, gjyq-

tarët, prokurorët, institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut, institucionet arsimore, orga-

nizat e shoqërisë civile, bizneset, studentët dhe të gjitha palët e interesuara.


Platforma ofron dy udhëzues që do të shërbejnë për të siguruar qasje më të lehtë dhe praktike në juridiksionin vendor dhe në atë ndërkombëtar përmes lidhjeve të strukturuar mes instrumenteve juridike dhe gjyqësore (praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut), të cilat zbatohen drejtpërsëdrejti në sistemin juridik të Republikës së Kosovës si dhe për t'i demonstruar lidhjet e Objektive për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe për të drejtat e liritë themelore të njeriut.

Më 10 dhjetor 2019 Institucioni i Avokatit të Popullit, në bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), me mbështetje financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë, lansoi Platformën për të Drejtat e Njeriut.

Pas padisë së LV-së, gjykata pezulloi vendimin e bordit të ZRrE-së

PRISHTINË, 16 JANAR (ER)- Lëvizja Vetëvendosje ka bërë me dije se Gjykata Themelore në Prishtinë ka pezulluar vendimin e Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) për shtimin e kapaciteteve me tarifa nxitëse për sistemet solare fotovoltaike. Kjo lëvizje ka theksuar se ky vendim është marrë pas padisë që kanë ushtruar kundër vendimit në fjalë të Bordit të ZRrE-së. "Anëtar i Kryesisë Sami Kurteshi dhe aktivisti Getoar Mjeku, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor, dorëzuan më 24 dhjetor padi ndaj vendimit të ZRrE-së për shtimin e kapaciteteve me tarifa nxitëse për sistemet solare fotovoltaike.

Më 14 janar u njoftuar nga Gjykata Themelore me aktvendimin ku aprovohet kërkesa jonë për pezullimin e këtij vendimi deri sa kjo çështje të shqyrtohet nga Gjykata. Rikujtojmë se ky vendim u morë më 27 nëntor 2019, teksa në Kosovë ishte shpallur ditë zie për viktimat e tërmetit në Shqipëri. Në atë mbledhje Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë pasi që e shtoi si pikë të rendit të ditës aty për aty dhe pa arsytim valid, mori vendim për një skemë të re mbështetëse me tarifa nxitëse, duke u garantuar disa prodhuesve të para-caktuar të energjisë së ripërtërishtme blerjen e energjisë me çmim shumë



më të lartë se vlera e tregut", ka njoftuar Vetëvendosje. Sipas Vetëvendosjes një vendim i tillë ishte marrë edhe në vitin 2016. "Të njëjtin vendim e patën

marrë edhe në 2016 me një çmim edhe më të lartë se tash, 136.4 euro për MWh që u paguhet për 10 vite dhe mbi 50 për qind të tyre një grupi finan-

ciar, Devollit. Por nuk u mjaftoi kjo, e përsëritën duke e zgjeruar në 20 MW dhe me tarifën nxitëse 85.5 euro për MWh, për 12 vite, tash mbi 60 për qind të njëjtit grup financiar. Vendimi i paditur nga ne nuk ka bazë ligjore dhe përbën shkelje të rëndë të ligjeve në fuqi, cenon shtetin e së drejtës dhe cenon interesin publik në favor të interesave private të cilat në rastin konkret nuk shërbejnë për asgjë tjetër në sektorin energjetik e as obligimeve ndërkombëtare të Kosovës, përveçse nga faturat tona të energjisë do të paguhet Devolli e të tjerë për çmimin e energjisë", ka njoftuar LV-ja.

Ministria e Inovacionit e bën me laborator të teknologjisë Gjimnazin e Drenasit

PRISHTINË, 16 JANAR (ER)- Me investimin e rreth 25 mijë eurove nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, është inauguruar të enjten laborator i teknologjisë dhe inovacionit në Gjimnazin "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" në Drenas. Ministri në detyrë i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Muzafer Shala, në ceremoninë inauguruese ka thënë se si ministri në vazhdimësi kanë punuar për forcimin e ekosistemit të profesioneve në fushën e teknologjisë. Sipas tij, në vendin tonë është dëshmuar se ka rëndësi transformimi digjital, i cili tashmë është duke ndodhur në gjithë botën. "Në bazë të Forumit Ekonomik Botëror, 65 për qind të fëmijëve që hyjnë në klasën e parë do të bëjnë punë që nuk ekzistojnë tash. Dhe të gjitha këto punë do të kërkojnë shkathtësi nga teknologjia e informacionit dhe makatronika. Prandaj ky inaugurim i këtij laboratorit është shumë e rëndësishme për të gjitha këto që u thanë më sipër", ka thënë ministri Shala. Me këtë rast, ministri ka folur



edhe për disa aspekte tjera, që si ekosistem i inovacionit dhe ndërmarrësisë ka rëndësi të madhe ndërlihdja e politikbërjes, akademisë me inovacionin dhe ndërmarrësin. "Para disa muajsh kam thënë se në Kosovë do t'i krijojmë 50 mijë inxhinierë

nga fusha e IT-së dhe mekatronikes. Ne në Kosovë kemi kompani, të cilat i kanë kaluar të gjithë kufijtë dhe sot janë punëdhënës serioz, të cilët po e bëjnë sektorin e shërbimeve 'ousource' si sektorin e vetëm me bilanc pozitiv ne eksport", ka theksuar

ministri Shala. Sipas tij, ka kërkesa të mëdha të njerëzve me shkathtësi në ICT, prandaj duhet investuar në këso hapësirash përmes, të cilave do të forcohet talenti i të rinjve tanë. Ndërkaq, kryetari i Komunitetit të Drenasit, Ramiz Lladraovci, ka

thënë se investimi i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, do të mundësojë ngritjen e cilësisë në arsim. Në këtë ceremoni ka marr pjesë edhe një delegacion gjerman i kryesuar nga themeluesja e Education Unlimited, Kerstin Labonte.

Toyota investon në zhvillimin e veturave që fluturojnë

TOKIO, 16 JANAR- Prodhuesi i veturave, Toyota i Japonisë thotë se do të investojë rreth 400 milionë dollarë në një kompani që punon për të zhvilluar vetura fluturose të cilat do të siguronin "shërbime të shpejta, të qeta dhe të përballeshme të transportit ajror". Toyota të enjten ka njoftuar se investimi në transportin ajror

ka qenë një "qëllim afatgjatë". Presidenti i kompanisë, Akio Toyoda, ka thënë se kompania që ai e udhëheq po transformohet. "Ndërsa ne vazhdojmë punën tonë në biznesin e veturave, kjo marrëveshje vendos vështrimin tonë në qiell", ka deklaruar Toyoda në një deklaratë. "Përmes kësaj përpjekjeje të re dhe emocionuese, shpresojmë të ofrojmë lirinë e

lëvizjes dhe kënaqësisë tek klientët kudo, në tokë, dhe tani, në qiell", ka thënë ai. Investimi i Toyota-s do të bëhet në kompaninë Joby Aviation, e cila po zhvillon një mjet transporti elektrik, me katër pasagjerë, që ngritet dhe ateron vertikalisht, si një helikopter. Kompania parashikon që prodhimi i saj të përdoret për transport komercial.



Bizneset diskutojnë mbi zhvillimin e ndërmarrësisë sociale në Kosovë



EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 16 JANAR- Si metodë me anë të së cilës zhvillohen dhe financohen zgjidhje të ndryshme të problemeve shoqërore, ndërmarrësia sociale është duke u konsideruar si trend në rritje, dhe dita-ditës është duke u vërejtur një orientim më i madh i vëmendjes së bizneseve në aktivitete të lidhura me këtë lloj të ndërmarrësisë. Kështu është thënë të enjten në tryezën me temën:

"Ndërmarrësia Sociale në Kosovë", e cila është organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane. Antigona Limani, udhëheqëse për marketing dhe marrëdhënie me publikun në "Raiffeisen Bank" ka thënë se edhe pse kjo bankë është kompani komerciale, ajo vazhdimisht është angazhuar për t'i ndihmuar dhe identifikuar organizatat dhe kompanitë me ndikim social, të cilat kanë pasur zhvillim të theksuar gjatë viteve të fundit në Kosovë.

Për më tepër, ajo ka përmendur

disa nga shtyllat kryesore në të cilat kjo bankë është fokusuar në aspektin e zhvillimit të ndërmarrësisë sociale.

Limani ka thënë se është e nevojshme që të mbështeten bizneset të cilat ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve shoqërore, në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi mes bizneseve dhe ky aktivitet të ketë ndikim edhe më të madh në shoqëri.

Ndërsa Greta Kamberi, specialiste e rekrutimit në "Gjirafa", ka thënë se aktivitetet e kësaj kompanie në aspektin e ndërmarrë-

sisë sociale janë të shumta, duke përmendur se fokus kryesor në vitin e fundit kanë pasur edukimin.

Kamperi është shprehur se beson fuqishëm se përgjegjësia sociale është një kulturë që vjen nga brenda, dhe që duhet të integrohet në themelet e çdo kompanie.

Më tutje, ajo ka thënë se është me rëndësi që ndërmarrësia sociale po zhvillohet dita ditës në Kosovë, duke inkurajuar të gjitha bizneset që të u shkojnë mbrota këtyre aktiviteteve ose

kauzave të cilat janë në të mirën e shoqërisë.

Krahas kësaj, Kamperi ka thënë se "Gjirafa" është gjithmonë e gatshme të bashkëpunojë në iniciativa që vijnë nga ndërmarrje të ndryshme ose akterë të tjerë që kontribuojnë në zhvillimin e ndërmarrësisë sociale.

Gjatë kësaj tryeze, si sfida kryesore për zhvillimin e këtij lloji të ndërmarrësisë është përmendur mungesa e mirëmbajtjes pas implementimit të projekteve, që shpesh rezulton në pakënaqësi nga shoqëria.

Firmoset marrëveshja për autostradën Shkup-Bllacë



SHKUP, 16 JANAR- Qeveria e Maqedonisë së Veriut ka firmosur marrëveshjen me një firmë ndërtimore për nisjen e punimeve për dy kilometrat e parë të autostradës Shkup-Bllacë, e cila do të lidhë Maqedoninë e Veriut me Kosovën, përmes autostradës "Arbën Xhaferi".

Punimet pritet të nisnin në pranverë, ndërsa deri atëherë pritet të përfundojë edhe procesi i

shpronësimit të 68 parcelave të tokës, në pronësi të banorëve të Bllacës.

Autostrada do të jetë në gjatësi prej 12 kilometrash, me një kosto prej 120 milionë eurosh. Dy kilometrat do të financohen nga buxheti i shtetit të Maqedonisë së Veriut, ndërsa pjesët tjera me kredi të Bankës Botërore dhe nga fondi i Ballkanit Perëndimor. Gjatësia totale e autostradës do të jetë

12.5 kilometra dhe pritet të vihet në shfrytëzim në vitin 2021.

"Projekt i një rëndësie të veçantë strategjike për vendin dhe gjithë rajonin. Unë besoj se shumë shpejt Prishtinën dhe Shkupin do ta lidhim me një autostradë moderne, e cila do të kalohet për më pak se 45 minuta. Këto dy kryeqytete do të bëhen më të afërta në rajon, duke ofruar një mundësi për lidhshmëri të njerëzve, mallrave dhe një klimë

të re të bashkëpunimit mes shteteve dhe popujve", ka deklaruar zëvendëskryeministri i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, koordinatori i projektit. Ndërtimi i kësaj autostrade është premtuar që para 16 vjetësh, por për shkak të mungesës së gatishmërisë politike, para së gjithash nga pala maqedonase, ai është zvarritur - gjë që shpeshherë ka çuar edhe në përplasje mes partive politike.

Prej 1 shkurtit pagesat mund të bëhen përmes terminaleve POS pa kosto shtesë

PRISHTINË, 16 DHJETOR (ER)- Më 26 dhjetor të 2019-s Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ka miratuar amendamentimet e "Rregullores për Instrumentet e Pagesave Elektronike", të cilat hyjnë në fuqi nga data 1 shkurt 2020. Me anë të këtyre ndryshimeve klientët e bankave mund t'i përdorin

kartelat e tyre për kryerjen e pagesave për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, përmes të gjitha terminaleve POS pa marr parasysh se cilës bankë i përkasin, pa aplikim të kostove shtesë. "Këto ndryshime janë të bazuara në praktikat dhe standardet e BE-së, të cilat kanë për qëllim rritjen e përdorimit të kartelave dhe instrumenteve tjera të page-

save elektronike, si shërbime më efikase me kosto më të ulët për ofruesit dhe përdoruesit e shërbimeve të pagesave. Prandaj, me anë të këtij njoftimi i inkurajojmë të gjithë qytetarët të përdorin kartelat e tyre për pagesë, si mjete të sigurta pagese pa ndonjë kosto shtesë", është bërë me dije në njoftimin e BQK-së.



Kryetari i Kaçanikut takohet me gratë asambleiste

KAÇANIK, 16 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, ka pritur në takim grupin e grave asambleiste të Kuvendit Komunal. Në këtë takim Ilazi u ka dëshiruar atyre suksese dhe

punë të mbarë për vitin 2020, derisa ka kërkuar sa më shumë të punohet dhe të avokohet për integrimin e grave në jetën publike dhe institucionale. Në këtë takim është diskutuar

edhe për hartimin e planit të punës të këtij grupi, ndërsa kryetari Ilazi ka shprehur përkushtimin institucional në përkrahje të aktiviteteve që do të realizohen gjatë vitit 2020.



Drejtuesit e KPMM-së vizitojnë Malishevën, shkak pezullimi i lejeve për gurëthyesit

MALISHEVË, 16 JANAR (ER) - Drejtuesit e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), të përfaqësuar nga kryesuesi i bordit të këtij komisioni, Musa Shabani, drejtori ekzekutiv Ramiz Krasniqi dhe zyrtarja ligjore, Selvete Greiqevci, janë takuar të enjten me kryetarin e Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, kryesuesin e Kuvendit të Komunës së Malishevës, Rrahim Morina dhe përfaqësuar e subjekteve politike, Alban Mazreku nga PDK-ja, Alban Krasniqi nga Vetëvendosja dhe Kastriot Berisha nga AAK-ja. Qëllimi i këtij takimi ishte sqarimi dhe konsultimi lidhur me vendimin e Kuvendit Komunal të Malishevës për pezullimin e përkohshëm të lejeve dhe pëlqimeve për të gjithë gurëthyesit dhe operatorët e tjerë që merren me veprimtari të ngjashme në territorin e kësaj komune. Zyrtarët më të lartë të KPMM-së



kanë dhënë sqarimet e tyre lidhur me mënyrën e dhënies së lejeve për zhvillim të veprimtarive për hulumtime, gurëthyes, separacione, për-

punim të betonit dhe veprimtari të e ngjashme, ndërsa përfaqësuesit e Kuvendit Komunal të Malishevës e kanë arsyetuar vendimin në fjalë për pezullimin

e përkohshëm të gurëthyesve me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë për dhënien e këtyre lejeve, si dhe për verifikimin e zbatimit të kriterëve nga

gurëthyesit, me qëllim të mbrojtjes së jetës së qytetarëve si pasojë e ndotjes së ambientit, minimeve që bëjnë këta gurthyes, pastaj dëmtimin e rrugëve dhe për çështje të tjera të ndikimit negativ në mjedis.

Pas shumë sqarimeve të bëra në mes të dy palëve, kryesuesi i bordit të KPMM-së, Musa Shabani, ka deklaruar se ky komision tani e tutje nuk do të lëshojë leje operimi pa pëlqimin e Kuvendit të Komunal të Malishevës. Ai ka sqaruar se KPMM-ja nuk mund të bëjë tërheqje retroaktive të lejeve, duke paralajmëruar se Komuna e Malishevës do t'i bartë të gjitha pasojat e tërheqjes eventuale të pëlqimeve dhe lejeve.

Ndërsa kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, ka thënë se do të përpiqet për zbatim të ligjeve dhe vendimeve si dhe do të angazhohet për zgjidhjen e të gjitha çështjeve me interes për qytetarët të kësaj komune.

Latifi kërkon nga inspektorët lirim e trotuareve

RAHOVEC, 16 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka mbajtur një takim me inspektorët komunalë, nga të cilët ka kërkuar të merren aksione për lirim e trotuareve dhe largimin e hekurishteve të cilat janë në vende të papërshatshme në këtë komunë. Latifi ka theksuar se qëllimi i këtij takimi ishte forcimi dhe shtimi i inspektimeve në territorin e Rahovecit. "Kërkova që të jenë më operative në terren, në zbatim të plotë të ligjit, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira higjieno-sanitare, mbrojtjes së mjedisit, për rend dhe rregull urbanistik etj. Inspektoratit në bashkëpunim me policinë u është dhënë e drejta ligjore që të shqiptojnë apo të propozojnë



edhe masa ndëshkuese për subjektet që shkelin apo nuk zbatojnë

ligjet, për t'u siguruar që të gjithë të trajtohen barabartë

para ligjit. Me theks të veçantë kërkova të ndërmarrin masa për:

lirim e trotuareve, trajtimin me standarde dhe largimin e hekurishteve që janë pa vend e në kundërshtim me ligjin, ndërtime pa leje, deponitë e mbeturinave, shqiptimin e gjobave mandatore dhe heqjen e reklamave të vendosura kundërligjshëm, në të gjitha vendbanimet", ka thënë Latifi. Ai ka theksuar se bashkëpunimi i ndërsjellë dhe funksionaliteti më i mirë i organeve komunale, para se gjithash zbatimi i ligjit, janë kontribut i domosdoshëm për më shumë siguri dhe për mjedis më të pastër e ekologjik për qytetarët e Rahovecit. I pranishëm në këtë takim ka qenë edhe drejtori i Inspektoratit, Besnik Hoti dhe ai i Urbanizmit, Rumir Zhuniq.

Muharremaj premtan zgjidhjen e problemeve të qytetarëve

Suharekë, 16 janar (ER)- Në Komunën e Suharekës si çdo të enjte kanë ardhur një numër i konsiderueshëm i qytetarëve të cilët janë takuar

me kryetarin e kësaj komune, Bali Muharremaj. Kjo komunë ka bërë me dije se qytetarët kanë bashkëbiseduar me Muharremajn si dhe

kanë paraqitur kërkesat dhe problemet e tyre. "Pasi ka dëgjuar të gjithë veç e veç, kryetari ka dhënë përgjigje në të gjitha kërkesat e tyre dhe

ka premtuar se brenda mundësive që ka komuna, kërkesat e tyre do të zgjidhen", ka njoftuar Komuna e Suharekës.



Fizika dhe kimia simetrike, udhëtim drejt universit (3)

Elektronet e lira nëpër përcuesin elektrik



Shkruan: Naim
KRASNIQI, fizikan

Në të tri rastet që i sqaruar më parë lidhur me fushën magnetike nën përcuesin elektrik, mbi përcuesin elektrik, dhe në brendësi të përcuesit elektrik në formë solenoidi, gjilpëra magnetike detekton dy pole magnetike, atë të polit magnetik të veriut (N) dhe polit magnetik të jugut (S). Mbështetur në këtë, shkencërisht mendohet se fusha magnetike buron nga poli magnetik i veriut (N) dhe hynë në polin magnetik të jugut (S), kurse fusha magnetike është krijuar nga rryma elektrike. Po ne nuk mund ta kuptojmë fushën magnetike nëse nuk e kuptojmë edhe rrymën elektrike, pikërisht lëvizjen e kësaj rryme nëpër përcues. Mendohet se rryma elektrike krijohet nga lëvizja e elektroneve të lira nëpër përcues, madje shkenca shkon edhe më larg duke theksuar se: Rryma elektrike krijohet nga qarkullimi i elektroneve të lira nëpër një material që e përçon rrymën elektrike. Një elektron i lirë i një atomi e sulmon një elektron të një atomi tjetër, duke e larguar nga orbita dhe duke zënë vendin e tij. Kurse atomi i lirë që është larguar e sulmon një elektron tjetër të një atomi tjetër, dhe në të njëjtën mënyrë e largon nga orbita e tij dhe e zë vendin e tij, e kështu më radhë kjo lëvizje e elektroneve nga një atom në

një atom tjetër e krijon rrymën elektrike ashtu sikur shihet në figurën 3. d).

Shpjegimi është, gjithsesi, shumë më i komplikuar, por ne do të ndalemi vetëm te elektronet e lira, si dhe te ajo se si mendohet se lëvizin këto elektrone të lira nëpër përcues. Një problem më vete është nevoja për të sqaruar se nga na erdhën këto elektrone të lira, si dhe ku do mbesin protonet dhe neutronet në rast se këto lëvizin lirshëm nëpër përcues. Për ta sqaruar këtë ne prapë do t'i drejtohem natyrës, që të kuptojmë se a mund të ekzistojnë elektrone të lira. Dihet se elektronet kanë ngarkesë negative, dhe rrotullohen rreth bërthamës së atomit, ngjashëm sikur rrotullohen trupat e tjerë qiellorë rreth një trupi qiellorë. Apo ashtu sikur rrotullohen satelitët natyral rreth trupave qiellorë, qoftë rreth tokës, jupiterit, saturnit, uranit apo neptunit. Të thuhet se elektronet e lira lëvizin nga një atom te tjetri është tërësisht e ngjashme sikur të thuhet se satelitët e lirë natyral lëvizin nga një trup qiellorë në tjetrin, apo sikur të themi se Hëna largohet nga orbita e Tokës, dhe shkon në drejtim të Jupiterit, sulmon dhe e zë vendin e satelitit natyral Evropa, kurse Evropa pasi të largohet prej orbitës së Jupiterit, shkon drejt planetit të Saturnit duke e dëbuar Titanin dhe kështu më radhë. Në shkencë thuhet se elektronet e lira janë ato që lëvizin, por që nuk janë elektrone orbitale stabile. Por kjo bie në kundërshtim me numrin e elektroneve që i përmbajnë përcuesit elektrik: le të merret si përcues i rrymës që është bakri, i cili përmban 29 protone, 29 elektrone dhe 35 neutrone.

Nga kjo rrjedhë se pos 29 elektrone te bakri ka edhe elektrone të tjera të lira. Ky pohim është kundërthënës, sepse bie në kundërshtim me strukturën e atomit të bakrit.

Një problem tjetër më vete është se asnjëherë nuk është sqaruar se si ato mund të jenë elektrone të lira, kur dihet se elektronet janë ngarkesa elektrike. Prandaj mund të thuhet se në pohimin se elektronet e lira lëvizin nëpër përcues elektrik duket se logjika ka kapituluar.

Ajo që unë dua të pohoj është e kundërta, se elektronet e lira as që ekzistojnë dhe as që lëvizin nëpër përcues, edhe pse kemi një shpejtësi të rrymës elektrike prej 300 000 km/s. Shpjegimi im është ky: rryma elektrike ka vetëm një zgjidhje, dhe mund të krijohet nga protonet elektronet dhe neutronet, si dhe asnjëra nga këto ngarkesa nuk lëvizin me shpejtësi të ndryshme nga njëra-tjetra.

Këtë rrjedhë sugjerimi se lëvizja e tyre është krejt ndryshe nga ç'mendohet sot. Nëse lëvizin këto ngarkesa, atëherë ato lëvizin me shpejtësi të njëjtë. Çka domethënë kjo? Se ato ngarkesa nuk lëvizin si grimca të veçanta, respektivisht si elektrone ashtu sikur mendohet tani. Jo, ato lëvizin së bashku, lëvizin si atome.

Madje, ka edhe një mundësi tjetër. Elektronet, protonet dhe neutronet mund të mos lëvizin fare nëpër përcues. Atëherë, me të drejtë, do të shtrohej pyetja: si lëvizë rryma elektrike? Ka një mundësi tjetër: rryma elektrike kalon përmes ndryshimeve energjetike te këto grimca. (Në të ardhmen do të sqarojë se si kalon rryma elektrike nëpër përcues, që do të jetë një parashtrim krejt

ndryshe nga ai i zakonshmi).

Nga ana e tjetër shkenca elektronin e njeh sikur ngarkesë negative, e cila posedon vetëm një fushë elektrostatische negative. Kjo pikëpamje na përballë me një vështirësi tjetër: duke qenë se fusha magnetike në të gjitha rastet posedon dy pole magnetike veri (N) dhe jug (S), atëherë shtrohet pyetja se nga vjen kjo fushë magnetike me dy pole magnetike, po që se është e vërtetë se elektroni është një ngarkesë që posedon vetëm një fushë elektrostatische negative (ashtu sikurse e pohon shkenca sot)?

Fizika e sotme nuk mundet ta shpjegojë këtë fakt në mënyrë të qëndrueshme e shkencore. Shpjegimin e saj kundërshton një e dhënë e njohur: gjilpëra magnetike ka dy pole, atë të veriut (N) dhe jugut (S) ashtu sikur ka fusha magnetike që ka të njëjtat pole magnetike. Pikërisht për këtë, gjilpëra magnetike, përkundër shpjegimit të mangët të fizikës, e jap saktë se nëse ka fushë magnetike me dy pole, problem qëndron te elektroni në lëvizje. Ajo që tregon gjilpëra magnetike duhet të lexohet përtej rutinës dhe të kuptohet: gjilpëra magnetike tregon saktë se edhe elektroni duhet t'i ketë njëjtë dy pole. Këtë fenomen, pra se edhe elektroni duhet të ketë një fushë magnetike me dy pole, asnjëherë fizika nuk e ka njohur.

Këtë problem edhe pse shkenca deri tani nuk e ka njohur, zgjidhjen e këtij problemi e kam sqaruar në botimet te në "Epoka e re" - Krasniqi 2019.

Në botime sqarohet saktë se nga elektroni njëkohësisht burojnë dy fusha: Fusha elektrostatische e elektronit $[? (- E E)]$ dhe fusha antielektrostatische e elektronit $[? (- (- E E))] = [? (+ E E)]$. Prandaj elektroni posedon

një fushë elektrostatische negative e $[? (- E E)]$ ashtu sikur e njeh fizika, por në brendinë e tij ka edhe një fushë antielektrostatische të ngjashme sikur protoni $[? (+ E E)]$ të cilën ende nuk e ka njohur fizika e tanishme. Duke u rikthyer në sqarimin e mëparshëm se rryma elektrike nuk mund të krijohet nga lëvizja e lirë e elektroneve, sepse absolutisht një fenomen të tillë nuk e lejon natyra, kështu që në prodhimin e rrymës elektrike nuk mund të përjashtohen nga procesi as bërthama e atomit, në të cilën bëjnë pjesë protonet dhe elektronet.

Ngjashëm sikur janë sqaruar elektronet, po ashtu është sqaruar edhe struktura e brendshme e protonit, ku tregohet qartë se edhe nga protoni burojnë njëkohësisht dy fusha.

Fusha e parë që buron nga protoni është fusha elektrostatische e protonit $[? (+ E E)]$ e cila njihet nga fizika, por nga brendësia e tij buron edhe fusha antielektrostatische e protonit $[? (- E E)]$.

Prandaj edhe protoni posedon një fushë elektrostatische pozitive e $[? (+ E E)]$ ashtu sikur e njeh fizika, gjithashtu në brendinë e tij ka edhe një fushë antielektrostatische të ngjashme sikur elektroni $[? (- E E)]$ të cilën ende nuk e ka njohur fizika e tanishme. Edhe pse një rol tejet të veçantë neutronet kanë në lëvizjen e rrymës elektrike, tani nuk do t'i përfshimë në rryma elektrike nga fakti se nuk janë te ngarkuara dhe nuk posedojnë fusha elektrostatische. Bazuar në atë se sikur nga protonet ashtu edhe nga elektronet burojnë nga dy fusha. Duhet potencuar se elektronet dhe protonet rrotullohen në kahe të kundërt me njëra tjetrën. (VIJON)




Fig 3d

Senati nis gjyqin kundër presidentit Trump

Me leximin e dy neneve me zë të lartë në sallë për shkarkimin e tij, Senati amerikan ka nisur gjyqin kundër presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, duke hapur rrugën për një gjykim historik që do të zhvillohet për herë të tretë në historinë amerikane

WASHINGTON, 16 JANAR - Senati amerikan ka nisur gjyqin kundër presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump dhe dy nene për shkarkimin e tij janë lexuar me zë të lartë në sallë.

Leximi i akuzave ka hapur rrugën për një gjykim historik që do të zhvillohet për herë të tretë në historinë amerikane.

"Me sjelljen e tij dhe në kundërshtimin me betimin e tij kushtetues, Donald J. Trump ka abuzuar me fuqinë e tij si president", ka thënë demokrati, Adam Schiff, i cili do të udhëheqë ekipin prej shtatë menaxherësh, të përzgjedhur nga Dhoma e Përfaqësuesve, të cilët do të veprojnë si prokurorë gjatë hetimit, ka njoftuar rfe.

Më vonë, Senati do të ftojë shefin e Drejtësisë, John Roberts që të betohet si gjykatës kryesor i procesit.

Para tij më pas do të betohen edhe 100 senatorë që do të angazhohen si anëtarë të jurisë. Muajin e kaluar, Dhoma e Përfaqësuesve ka akuzuar Trumpin për keqpërdorim të pozitës që ka dhe pengim të punës së Kongresit në marrëveshjet e tij me Ukrainën.

Trumpi mohon akuzat, derisa procesin e shkarkimit e ka konsideruar "mashttrim" dhe "gjueti shtrigash".

Republikanët që drejtojnë Senatin pritet ta shfajësojnë Trumpin, po ashtu republikan, për çfarëdo keqbërje.

Sipas procedurave aktuale, gjyqi kundër Trumpit pritet të nisë më 21 janar.

Hetimet kanë nisur pas zbulimit të një bisede të 25 korrikut në

mes të presidentit Trump dhe presidentit të Ukrainës, Volodymyr Zelenskiy.

Një informator është ankuar duke pretenduar se Trumpi "ka përdorur pozitën e tij për të kërkuar ndihmë nga një shtet i huaj", në prag të procesit zgjedhor për një mandat tjetër presidencial.

Pjesa kryesore e gjyqit fillon të martën. Kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi i dërgoi të mërkurën në Senat akuzat ndaj presidentit Donald Trump, pas javësh debat mbi

rregullat e gjyqit, ka njoftuar voa.

Në një ceremoni të pazakontë, procesi për shkarkimin e një presidenti zhvendoset nga Dhoma e Përfaqësuesve në Senat, katër javë pasi Dhoma e Përfaqësuesve me shumicë demokrate, votoi pro akuzave për presidentin Trump.

"Dhoma e Përfaqësuesve votoi pro akuzave për shkarkimin e presidentit të Shteteve të Bashkuara, një vendim që hyn në histori", tha kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi.

Pelosi emëroi të mërkurën shtatë ligjvënës që do të luajnë rolin e prokurorëve në gjyqin që zhvillohet në Senat. Ata kryesohen nga kreu i Komisionit të Zbulimit, Adam Schiff dhe ai i Komisionit Juridik, Jerrold Nadler.

"Dokumente të reja dhe dëshmitarë shtesë, provojnë pa

mëdyshje fajin e presidentit dhe ne kemi zbuluar përpjekjet e disa personave nga shumica në Senat për të mbajtur një gjyq të sajuar. Populli amerikan e kupton që një gjyq pa prova, pa dëshmitarë, nuk është gjyq por një lojë dhe kjo nuk do të pranohet", tha Nadler.

Demokratët do të përpiqen të provojnë se Trumpi shkeli postin e presidentit kur inkurajoi ndërhyrje të huaj për zgjedhjet e vitit 2020, në një telefonatë më 25 korrik me presidentin ukrainas, Volodymyr Zelenskiy. Pelosi kishte shtyrë dërgimin e akuzave, në një përpjekje të pasuksesshme për të detyruar udhëheqësin e shumicës republikane në Senat, Mitch McConnell që të pranonte kërkesën e demokratëve për dëshmitarë. "Nuk bëhet fjalë për nuancat e ndihmës së huaj për Evropën Lindore. Është një lojë e pastër politike",

tha McConnell.

McConnell ka thënë se secila palë do t'i paraqesë argumentet, para se të konsiderohet çështja e dëshmitarëve. Një pikëpamje, e mbështetur nga senatorët e tjerë republikanë. "Pasi të kemi një ide për çfarë bëhet fjalë për sa u takon provave, argumentet e prokurorëve dhe ato të mbrojtjes, duhet të pyesim veten: a na duhet të dëgjojmë prova shtesë? Kemi nevojë të dëgjojmë dëshmitarë të tjerë?", thotë senatori republikan John Kennedy.

Shtëpia e Bardhë u tha gazetarëve se do të jetë aq e lehtë të mbrohet presidenti Trump, saqë gjyqi do të zgjasë vetëm dy javë. "Është një mashttrim. Le t'i japim drejtim", tha presidenti Trump.

Por gjyqi i fundit për shkarkimin e një presidenti, ai i vitit 1999 për Bill Clintonin, zgjati mbi një muaj.



Duma ruse miraton kryeministrin e ri

MOSKË, 16 JANAR - Duma Shtetërore, që është Dhoma e Ulët e Parlamentit të Rusisë, e miratoi me shumicë votash të emëruarin e presidentit Vladimir Putin për kryeministër, Mikhail Mishustin.

Në favor të Mishustinit votuan 383 ligjvënës, ndërsa 41 abstenuan.

Të mërkurën, Putini e propozoi Mishustinin, ish-shef i Shërbimit Federal të Taksave, për kryeministër, pasi Qeveria e Dmitry Medvedevit dha dorëheqje.

Medvedevi tha se dorëheqja pason thirrjet e Putinit për ndryshime të

mëdha kushtetuese.

"Në këtë kontekst, ne, si Qeveria e Federatës Ruse, duhet t'ia sigurojmë presidentit të vendit tonë mundësinë për të ndërmarrë të gjitha vendimet e nevojshme. Në kushtet e tilla, mendoj se Qeveria e Federatës Ruse ka bërë hapin e duhur me dorëheqje", tha Medvedevi, teksa njoftoi për dorëheqjen.

Gjatë fjalimit të së mërkurës drejtuar kombit, Putini foli për ndryshime kushtetuese që do t'i rrisnin kompetencat e parlamentit,



përpara përfundimit të mandatit të tij, më 2024.

Shumë vëzhgues dyshojnë se Putini po përpiqet të përgatisë terrenin për të vazhduar sundimin e tij në një kapacitet të ri.

Putini, 67 vjeç, ka dominuar politikën ruse për dy dekada, duke shërbyer herë si president, herë si kryeministër nga viti 1999.

Në vitin 2018, ai është rizgjedhur president për një mandat të ri 6-vjeçar.

Me ligjin aktual, ai do të duhet të tërhiqet pas përfundimit të mandatit.

WILLIAM WALKER E NDALI SERBINË



Ismet SYLEJMANI

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, diplomati i shquar, shefi i OSBE-së në Kosovë, figura e shquar botërore, personazhi historik e legjendarë William Walker është njëri nga burrat e mëdhenj të superfuqisë planetare, që e NDALI SERBINË!

500 vjet nën perandorinë turke dhe 100 vjet nën perandorinë serbe, Serbia, bëri gjithëçka të keqe, antinjerëzore e antihumane kundër popullit e kundër

Kombit shqiptar!

Serbia vrau dhe preu, masakroi dhe shkatroi, dhunoi e shpërnguli shqiptarët, që tua merrte çdo pëllëmbë toke e tua humbte nga faqja e gjeografisë dhe e globit Atdheun!

Kundër Serbisë pushtuese gjithë jetën e Tij, nëpër breza, në dekada e në shekuj, ka luftuar me heroizëm të pashembullt populli shqiptar! Populli shqiptar luftën kurrë nuk e ka ndalë për tu pavarësuar nga Serbia pushtuese!

Edhe në kohën e perandorisë turke, edhe në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizerenit, edhe në kohën e shpalljes së Pavarësisë së Shqiperisë, edhe kur ndahej e copëtohej Shqipëria në Versajë, në Londër e në Berlin, edhe kur luftohej gjatë Luftës së Parë Botërore, edhe gjatë LANÇ në LDB, edhe gjatë shpërbërjes së ish-perandorisë jugosllave dhe në fund edhe gjatë luftës së

armatosur, çlirimtare e titanike të UÇK-së!

Vetëm gjatë luftës së UÇK-së, populli shqiptar i Kosovës arriti që në anën e tij të kishte aleat të madh superfuqinë botërore SHBA, dhe kjo u bë e mundur, jo vetëm për shkak të drejtësisë së luftës çlirimtare që zhvillonte UÇK dhe populli shqiptar, jo vetëm pse u derdh gjak e ranë heroikisht në vijat e frontit luftëtarët trima e legjendarë Dëshmorë e Heronjë të Kombit, jo vetëm pse u plagësën e lanë gjymtyrët e tyre ushtarët çlirimtare, jo vetëm pse u masakruan, u dhunuan dhe u shpërngul një popull i tërë nga aparati shtetërorë e ushtarako-policorë i Serbisë pushtuese! Serbinë në Kosovë e para e ndali lufta heroike e UÇK-së, pastaj e ndali gjigandja SHBA, dhe e ndali NATO, por kjo u bë e mundur falë të famshmit, të madhit dhe të lavdishmit, hero-

it të gjalle, mikut të shekujve e mijëvjeqarëve të ardhshëm WILLIAM WALKER!

Duhet ta dijimë përgjithmonë, të thuhet kudo e nga çdo shqiptar, se Ambasadori William Walker, me qëndrimin e Tij heroik, prej burri sypatrembur, prej amerikani të paluhatsëm, e prej diplomati legjendarë, i doli në krah dhe u rreshtua në anën e të masakruarve të pafajshëm shqiptar në Reçak! Faleminderimi me miliona herë, është e do të ishte shumë pak i dashur dhe i nderuar Ambasadori emblematik i SHBA-ve WILLIAM WALKER! Të gjithë brezat e popullit shqiptar që kanë vdekur, të falënderojnë nga varret e Tyre për qëndrimin Tënd që e NDALË SERBINË!

Të gjithë shqiptarët e ardhshëm, do të përulen me respekt e nderim për Ty, për jetën dhe veprën Tëndë!

Ty duhet të ta marrim emrin, dhe ti pagëzojmë me emrin Tënd shqiptarët e ardhshëm!

Ty kudo nëpër qytetet dhe vendbanimet shqiptare duhet të të ngrisin përmendore, të emërojmë institucione edukativo-arsimore, politiko-kombëtare, ushtarako-paqësore, bulevarde, sheshe e rrugë me emrin Tënd të madh!

Faleminderit prindërve Tuaj që të kanë lindur dhe rritur, je burrëruar dhe ruajtur që të vini me mision në Kosovë, dhe të ngrisni zërin e të drejtoni gishtine ta thuani pa u frikësuar se: Serbia ka shkaktuar gjenocid në Kosovë!

Ambasador WILLIAM WALKER, Ti e ke NDALUR SERBINË!

Populli shqiptar, Atdheu e Kombi Ynë, të përulet përgjithmonë!

Prishtinë, 15 Janar 2019!



Flet Daut Dauti

KRIJIMI I SHQIPËRISË NË LONDËR SI REZULTAT I NJË KOMPROMISI TË FUQIVE TË MËDHA

Intervistoi:
Haqif MULLIQI
Fotografinë:
Agron SHALA

Dr. Daut Dautin e njohim që nga koha kur filloi të shkruajë në revista dhe gazeta të Prishtinës dhe kur paralajmëronte një karrierë të suksesshme në gazetari. Në fillim të viteve nëntëdhjetë e hasim edhe në publicistikën shqiptare. Objekt i shkrimeve të tij ishin, veçanërisht, temat historike, që zinin fill në dokumentet e Arkivit Britanik, me çfarë, në një

mënyrë apo tjetrën, iu imponua publikut shqiptar, gjithandej, jo vetëm me qasje që e detabuizonin të vërtetën historike, por edhe me "kundërvënien" që trajtesat e tij i bënin historiografisë shqiptare (zyrtare) që ishte krijuar deri atëherë dhe e cila kishte qenë nën kontrollin e rreptë të shtetit. Dr. Dauti ka mbaruar Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, ka magjistruar në Londër mbi të Drejtën e Unionit Evropian, kurse ka doktoruar në Universitetin e Lidsit (University of Leeds) në Angli për histori, në një fushë jashtëzakonisht interesante, e cila në vete

ngërthen periudhën që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e deri te Konferenca e Londrës. Studimet e dr. Daut Dautit janë një kontribut brilant për hedhjen dritë mbi periudha kohore për të cilat te ne është shkruar aq pak dhe, ndonjëherë, aq afër, të cilën e thekson në vlerësimet e veta për të edhe historiani i shquar britanik Noel Malkom. Kështu, në këtë intervistë të gjatë bërë posaçërisht për revistën "Akademia", do të flasim me të për disa prej çështjeve që e kanë karakterizuar periudhën kohore me të cilën është marrë ky studium, ku gjejmë edhe çështje të caktuara të cilat, pa dyshim, për

herë të parë hasen në publicistikën dhe histo-riografinë tonë. Dr. Daut Dauti ka botuar një mori librash publicistikë dhe shkencorë të cilët atë e bëjnë një prej zërave më të veçantë të historiografisë bashkëkohore shqiptare.

Zoti Dauti, jeni gazetar me shumë përvojë, publicist, jurist etj. Një pyetje që mund t'ju bëjë secili është kjo: si ju lindi një interesim kaq i madh, gati pasionues, për historiografinë?

DAUTI: Besoj se fillimisht kureshtja e gazetarit më ka shtyrë të shkoj në Arkivin Britanik apo në PRO (Public

Record Office). Kisha dëshirë ta dija se çka kanë shkruar diplomatët britanikë për ne shqiptarët, sidomos gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj. Më interesonte qëndrimi i tyre për shkak se ne nuk dinim aq shumë për marrëdhëniet shqiptaro-britanike të cilat nuk ishin aq të dendura e të ngushta e që pas Luftës së Dytë u ndërprejnë tërësisht. Në shqip, por edhe në anglisht, kishte fare pak material për këtë temë. Kontakti im me dokumentet e para në këtë arkiv krijoi efekt të madh. I kisha para meje dokumentet që dikur ishin sekrete, që flisnin për situata dhe personalitete të rëndësishme

e të cilat unë po i lexoja pas gjysmëshekulli. Këtë punë fillova ta bëja si gazetar, duke filluar nga një temë, por e vazhdova si publicist dhe më vonë u bë interesimi im pothuaj primar. Interesimi zgjerohej për shkak se dokumentet që i gjeja ishin voluminoze dhe mbulonin situata të shumta dhe periudha të ndryshme kohore. Ky interesim vazhdoi me dekada dhe kulmoi me hulumtimin e temës së doktoratës sime në Universitetin e Lidsit, e që është projekti im më i madh në historiografi. Por, në realitet, interesimi im nuk ka përfunduar këtu, pasi që ai vazhdon edhe më tutje të mëcytë për të shpalosur ende dosje të mbuluara nga pluhuri të cilat flasin për shqiptarët dhe historinë e tyre. Unë e vizitoj këtë arkiv, sikur edhe disa të tjerë, edhe sot pasi që aty gjithmonë ka diçka që ngacmon kureshtjen për të zbuluar gjëra që nuk i dimë apo për t'i ndriçuar ato që nuk i dimë mjaftueshëm apo sa duhet.

Mendoj se nuk janë të paktë ata që i kujtojnë disa fejtone interesante që i botuat në pjesën e parë të vitit 1991 e që vazhduan për shumë vjet: Shqiptarët në dokumentet e Inteligent Services, ai për Konfliktin Shqiptaro-britanik në Korfuz, fejtone mbi Kim Filbin dhe përpjekjet e CIA-s dhe të MI-6 që në periudhën 1949-1952 ta përmbysin regjimin komunist në Shqipëri dhe kështu me radhë. Çfarë e bënte të veçantë këtë lloj të dokumentimit të historiografisë shqiptare, në veçanti pas rreth pesë dekadave të sundimit të mendimit politik dhe ideologjik në këtë shkencë?
DAUTI: Shumicën e këtyre dokumenteve, me një entuziazëm të madh, i kemi përgatitur bashkë (unë dhe ti) për botim në gazeta. Ka qenë hera e parë që në publicistikën shqiptare botoheshin dokumente nga arkivat britanike, të cilat më parë kanë qenë (top) sekrete, të përpiluara nga diplomatët dhe konsujt që kanë shërbyer në rajonin e Ballkanit. Këto raporte fillimisht kanë qenë të dedikuara për të shërbyer për informim të një numri të vogël të zyrtarëve të lartë britanikë që duhej të merrnin vendime për këto çështje. Pra, të shohësh e lexosh diçka zyrtare që dikur ka qenë shumë e rëndësishme, është një punë që ta zgjerohet dëshirën për thellim të mëtejme të hulumtimit. Pastaj, mundësia që kjo të përhapet për lexim të gjerë, krijon një ndjenjë kënaqësie. Ta informosh publikun për herë të parë se çka përmbajnë dokumentet që kanë të bëjnë me Çështjen e Korfuzit, Kim Filbit dhe planit anglo-amerikan për rrëzimin e regjimit komunist në Shqipëri dhe temave të tjera, ka qenë një punë që unë edhe sot e konsideroj shumë të rëndësishme.

A mund të zhvillohet shkenca e historiografisë nën kontrollin e shtetit?
DAUTI: Historia është shkencë dhe shkenca nuk e duron 'rregullimin' apo çfarëdo ndërhyrje nga shteti. Ndërhyrja nënkupton caktimin e rregullave të studimeve dhe botimeve. Shkencëtarët, në mesin e tyre edhe historianët, nuk do të krijojnë pasqyrë të saktë e as të qartë sikur të kufizoheshin nga tema, mënyra e hulumtimit dhe interpretimit. Historiani është i obliguar që ta studiojë ndonjë temë dhe t'i paraqes faktet apo rezultatet përfundimtare pa marrë parasysh se si pasqyrohen ato në gjendjen ekzistuese në shoqëri. Ndërhyrja e shtetit ka qenë problem në shtetet e Evropës Lindore, sidomos, pra në ish-blokun komunist, siç e quajmë edhe sot një hapësirë të caktuar gjeografike ku bën pjesë edhe Ballkani. Gjatë komunizmit shtetet e kanë dizajnuar historinë në atë mënyrë që t'u shkonte për shtati sistemit politik dhe sundimit komunist. Në Ballkan, pos problemit të komunizmit, ka pasur edhe pretendime territoriale, sikur që ka edhe sot, dhe për këtë arsye historia është ngarkuar me një dozë të konsiderueshme të nacionalizmit. Këtu shteti ka kërkuar shërbim nga historianët. Por, ka shumë raste që vetë historianët kanë ofruar dhe vazhdojnë të ofrojnë shërbim brenda vijave që janë caktuar më herët nga shteti. Gjatë komunizmit janë ridizajnuar ngjarjet historike dhe janë ndërtuar personalitete dhe heronj në atë mënyrë që të jenë në shërbim të sistemit politik. Nëse shpjegimi është ndryshe nga ai që është caktuar, ka pasur intervenimi i shtetit me penalizim. Ne kemi pasur mjaft këso rastesh në Shqipëri, por edhe në Kosovë kur ky vend ishte pjesë e sistemit territorial dhe politik i Jugosllavisë. Ta zëmë, në historinë e Jugosllavisë thuhej se Kosova kishte hyrë vullnetarisht në shtetin jugosllav dhe se pas vitit 1945 kishte përparuar dhe ishte e barabartë me të gjithë popujt e këtij shteti. Prandaj, në Ballkan nuk janë të pakta rastet që tri apo katër histori të shteteve e përvetësojnë një ngjarje apo një personalitet, zakonisht hero, si të tyre. Sot, me këtë problem, ballafaqohet edhe historiografia shqiptare. Gjatë komunizmit është caktuar vija e studimit dhe interpretimit të ngjarjeve dhe personaliteteve. Sot historianët që dalin nga kjo vijë më nuk dënohen. Por, disa ende mendojnë se këta historianë shkaktajnë 'probleme' pasi që e kundërshtojnë vijën 'tradicionale'.

Në një prej shkrimeve tuaja të vonshme, që na ka rastisur ta lexojmë, ju shkruani për ndarjet e kufirit shqiptar në dëm të

Shqipërisë. Kosova mbeti jashtë, pjesa perëndimore e të ashtuquajturës "Serbi e jugut" (më vonë Maqedoni) gjithashtu ngeli jashtë, por edhe kufijtë e "Shqipërisë Londineze" vazhduan të kontestoheshin pas Luftës së Parë Botërore: kufiri i fshatrave të Korçës me Greqi, çështja e Vermoshit me Malin e Zi si dhe çështja e Shën Naumit atëbotë me Serbi. Pse mendoni se ndodhte kjo gjë?
DAUTI: Shqipëria është shtet i krijuar si rezultat i një kompromisi të Fuqive të Mëdha që u arrit në Londër në vitin 1913. Në realitet, shumica dërrmuese e shteteve të krijuara, sidomos nga shek. XIX, janë rezultat i kompromiseve ndërkombëtare. Por, ndaj Shqipërisë kompromisi ka qenë i tepruar, tejet i paarsyeshëm dhe, si i tillë, i dhembshëm për shqiptarët. Në masën e gjerë të shqiptarëve dhe në mesin e disa historianëve tanë, Britania e Madhe shihet me sy të keq. Londra, sipas tyre, është fajtorë për përgjysmimin e Shqipërisë. Në realitet është e kundërta dhe ka mundur të jetë edhe më keq sikur britanikët ta merrnin anën e rusëve dhe

francezëve që nuk favorizonin krijimin e një Shqipërie të pavarur. Sekretari i jashtëm britanik, Edward Grey, u deklarua se shteti i tij ishte neutral në këtë çështje dhe se Londra vetëm ofronte shërbim të mirë. Në realitet, Grey e përkrahu formimin e shtetit shqiptar. Formimi i shtetit shqiptar kishte domethënien e përfundimit të ëndrrave ruse dhe serbe për dalje në Adriatik dhe Mesdhe. Interesi britanik ishte që Rusia të qëndronte sa më larg këtyre deteve. Disa ditë para fillimit të Konferencës së Londrës, ministri i Jashtëm grek dhe ai serb u takuan me Edward Greyin dhe që të dy ia parashtruan të njëjtën pyetje: cili do të jetë qëndrimi britanik në Konferencë? Që të dyve, Grey iu përgjigj: Shqipëria do të formohet si shtet autonom. Por, megjithëkëtë, britanikët nuk u interesuan për shtrirjen etnike të shqiptarëve. Interesi i tyre ishte parandalimi i depërtimit rus në Ballkan dhe Adriatik. Ky ishte kompromisi i interesit britanik. Kompromisi për Shqipërinë e përjashtoi kriterin etnik në masë

të madhe. Pasi që ky përjashtim ka lënë jashtë kufirit gjysmën e territorit dhe popullsisë, shqiptarët kurrë nuk u pajtuan me të. Luftërat janë çaste kur ndryshojnë kufijtë dhe shqiptarët kanë vepruar në këto raste duke shpresuar se do t'i rregullojnë kufijtë sipas masës së tyre apo zbatimit të kriterit etnik. Pas Konferencës së Londrës, Fuqitë e Mëdha nuk treguan interesim për Shqipërinë edhe pavarësisht prej marrëveshjes që kishin arritur që ky shtet të ndihmohet për t'u ngritur dhe ecur i pavarur në këmbët e veta. Fuqitë e Mëdha nuk i respektuan obligimet që morën në Londër. Një situatë e tillë e pafavorshme për Shqipërinë vazhdoi edhe pas Luftës së Parë Botërore. Moskujdesi i këtyre fuqive kishte shenjë që Shqipëria kishte mbetur e pambrojtur. Kjo ishte arsyeja që shtetet fqinje vazhdonin t'i kontestonin kufijtë që kishin me Shqipërinë dhe mundoheshin të grabitnin territor aq sa ishte e mundshme.

(Marrë nga numri i shtatë i revistës "Akademia". Vijon në numrin e ardhshëm)



Botohet “Kanuni i Skanderbegut”, mbledhë e kodifikue nga Imzot Frano Ilia

Nga Imzot Angelo MASSAFRA*

Idealet e klerit katolik shqiptar për Fe, Kulturë dhe Atdhe nuk mbetën vetëm në planin teorik, por ndërtuan një mënyrë të mirëfilltë jetë për ripërtëritjen shpirtërore dhe kulturore të vetë popullit. Klerikët katolikë qenë idealistë që nuk u tërhoqën kurrë nga ideali i tyre. Ata nuk bënë asnjë lloj kompromisi me të keqen në dëm të besimit apo të atdheut. Për këtë arsye, mund t'i quajmë edhe yje që ndriçojnë në qiellin e kulturës shqiptare.

Mbledhja e traditave, e ligjeve dhe e zakoneve ka filluar prej tyre qysh herët. Dallojmë këtu në mënyrë të veçantë Atë Shtjefën Gjeçovin, Atë Bernardin Palajn, Atë Donat Kurtin, Dom Lekë Sirdanin dhe Imzot Frano Ilinë, paraardhësin tim në Arqipeshkvinë e Shkodrës.

Tradita e shkrimtarëve katolikë të Veriut e kishte kuptuar se për të njohur identitetin e popullit, më parë duhet të njohim historinë e tij. Këtë projekt të mirëfilltë kulturor e shpjegon më së miri Atë Pal Dodaj në ditarin e tij: "Për mue, detyra ma e saktë e atij që merret me literaturën në Shqipëri, do t'ishite mos me u shkëputë - sa ma shumë t'i jetë e mujtun - nga shpirti i popullit dhe me iu përmbajtë formave popullore, tue fisnikëruë, por pa i shtrembnue. Kjo do të bahet sa herë do të kërkohet nga njena anë të depërtohet e të zbulohen mendime, ndjenja që karakterizojnë popullin tonë; e nga ana tjetër, mos me u largue nga mënyrat e elokuencës popullore. Vetëm kështu, simbas mendimit tem, do të mund të përmbushet dalëngadalë evolucioni ynë letrar në rrugë progresive. Në rast se veprohet ndryshe, procesi ka për t'u krye me hope, me rrezikun që breznitë e ardhshme kanë për t'u shtrëngue me ba hapa



KANUNI i Skanderbegut

mbrapa."

Nëse analizojmë këtë pohim të fratit të njohur, dallojmë në të një program të qartë veprimi, të cilin e aktualizuan meshtarët e Kishës Katolike në vendin tonë. Me të drejtë, pas kaq vitesh shohim se këto ishin parime të drejta që udhëhoqën etërit e shquar të Kishës Katolike në Shqipëri për të ruajtur traditën dhe kulturën e popullit e njëko-

hësisht për të na e transmetuar atë përmes veprave të tyre. Nëse nuk do të kishim sot në dorë thesare, si: *Kangët e kreshnikëve* mbledhur nga Atë Bernardin Palaj e Atë Donat Kurti, *Kangët gegnishte* të Imzot Vincenc Prennushit, *Kanunin e Lek Dukagjinit* të Atë Shtjefën Gjeçovit, *Fjalët e urta dhe Frazheologjitë popullore* të Dom Aleksandër Sirdanit, *Prrallat*

Kombtare të Atë Donat Kurtit, *Skandërbegun mbas gojëdhanash* të Atë Marin Sirdanit e sa e sa vepra të tjera, kultura shqiptare do të ishte shumë e varfër. Ne nuk kemi nevojë të bëjmë hapa prapa, sepse punën e kanë bërë paraardhësit tanë. Na duhet vetëm t'i vlerësojmë etërit françeskanë, ata jezuitë dhe meshtarët dioqezanë për angazhimin dhe punën e tyre.

Mendoj se duhet t'i studiojmë përshtur për të përmirësuar kulturën e sotme. Edhe pse janë kontribute të shkruara para shumë kohëve, ato janë ende shumë të vyera dhe ne jemi të vetëdijshëm se kultura e sotme pa këto tekste do të ishte e mangët.

Ribotimi i *Kanunit të Skandërbegut* pas shumë kohësh është një vlerë e shtuar për kulturën juridike, dokesore e historike të popullit shqiptar. Vepra *Kanuni i Skandërbegut*, sipas parathënies dhe sipas dëshmimeve gojore të vetë autorit, ka kaluar kalvare të shumta nëpër arkiva, derisa pa dritën e botimit në vitin 1993.

Ky ribotim risjell punën e madhe e shumë të çmuar të Imzot Frano Ilinë. Ai që dënuar me vdekje si spiun i Vatikanit, dënim që ia kthyen në njëzet e pesë vjet burg e punë të detyruar. Kaloi shumë vjet në burgje dhe u persekutua si shumë klerikë të tjerë, por i qëndroi besnik fesë dhe punoi për atdheun edhe në vuajtje, mjerime e skamje. Megjithatë, puna e tij nuk ka shkuar dëm, por është vlerësuar dhe po vlerësohet përmes kësaj vepre.

Prandaj kam qenë i gatshëm t'i jap leje Provincës Françeskane "Zoja Nunciata" që ta ribotojë *Kanunin e Skandërbegut* të Imzot Frano Ilinë, sepse ka kohë që nuk gjendet më për lexuesin shqiptar. Kjo vepër botohet në formë anastatike duke u shërbyer jo vetëm studiuesve të gjuhës shqipe, të ligjeve dhe të traditave shqiptare, por edhe lexuesit të thjeshtë.

Uroj që leximi i kësaj vepre të shërbejë për të shpalosur edhe më tej historinë dhe mendësinë e popullit shqiptar, si edhe për të vlerësuar edhe më shumë punën dhe mundin e derdhur të autorit, Imzot Frano Ilinë, i cili hyn tashmë në vargun e personaliteteve të shquara të klerit katolik në Shqipëri. /Exlibris

*Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër-Pult

Drama njerëzore në romanin “Qyteti i fundit” të Petro Markos

Nga Xheni SHEHAJ

Italia ka kapitulluar. Italianët kanë ndërtuar një qytet brenda qytetit. Janë mbledhur të gjithë në Durrës dhe presin vaporët të vijnë për t'i marrë e për t'i dërguar në atdhe. Partizanët shqiptarë qëndrojnë me ta. I ndihmojnë me ushqime, cigare, lajme të reja. Autori vë përballë dy mendësi të ndryshme, dy kultura krejt të ndryshme. Ai zbulon karaktere, histori, drama njerëzore. Gjithashtu autori rrëfen historinë e dy të rinjve: Ana-Maria Montit, një 22-vjeçare viktimë e fashizmit (e gënjyer nga Arnaldo Massa, e ardhur në Shqipëri bashkë me familjen me mendjen që të bëheshin të pasur, por që përfundon prostitutë dhe kënaq epsheet e oficerëve) dhe togerit Lekë Gurra, 25-vjeçar, i pashëm, burrëror, i lakmuar nga partizanet. Ana-Maria dhe Leka njihen me njëri-tjetrin dhe pëlqehen. Takohen herë pas here të shkëmbi ku rri vajza e flasin. Atij i vjen keq për vajzën, nuk e fajëson atë në asnjë moment. Lirizmi zë vend në ndjenjat e Lekës i cili, nga ana tjetër, kujton me dhembje të fejuarën e vdekur, Malinë.

Arnaldo Massa, kriminel, vjedhës i floririt, mashtrues, përfaqëson të keqen, ligësinë. Intrigat e tij, ndërrimi i emrit, shantazhet që i bën familjes Monti, plagosja e Ana-Marias, e çojnë atë drejt zbulimit. Fundi i tij është i hidhur, pala shqiptare e arreston.

Fashizmi dhe komunizmi janë dy ideologjitë që dalin në pah në roman. Italianët, tashmë humbës, mallkojnë fashizmin që i gënjeu dhe i shkatërroi si komb; shqiptarët janë në prag të përfaqimit të komunizmit dhe shfaqin shenjat e para të dashurisë për të. Drama njerëzore në roman është e pranishme te secili personazh. Lufta i ka ndryshuar të gjithë. Dikujt i ka marrë emrin, identitetin, dikujt nderin, dikujt jetën, dikujt mendjen, dikujt dashurinë, dikujt fëmijërinë e rininë. Të gjithë kanë dalë të humbur prej saj. Të gjithë përjetojnë dramën e tyre.

Personazhet e romanit të Petro Markos janë në gjendje kalimtare. Njëra palë, italianët, presin të largohen për të rifilluar gjithçka nga e para. Pala tjetër, ajo shqiptare, pret që me ikjen e të huajve të fundit të fillojë ndërtimin e vendit.

SIMBOLET NË ROMAN

*Koha e ndodhjes
së ngjarjeve*

Romani fillon me natën e parë, si për të treguar dështimin, frikën, pasigurinë për të ardhmen dhe fantazmat e së shkuarës. Nata në vetvete është e frikshme, e mbushur me mendime të errëta

që ndjellin vetëm zymti e ankth. E gjithë historia zhvillohet në një hark kohor prej shtatë ditësh e netësh. Nis me natën e parë dhe përfundon me ditën e fundit, si për të treguar të kundërtën e nisjes së këtij kalvari. Dita është simbol i një fillimi të ri. Gjatë kësaj jave tregohen ngjarje e histori, ndodhin situata qesharake e prekëse.

Deti

Deti është i pranishëm gjatë gjithë veprës. Qyteti ku zhvillohen ngjarjet është qytet-porti i Durrësit. Në roman deti shërben si urë lidhëse mes dy vendeve fqinje; si urë lidhëse me vendlindjen, për sa u përket italianëve (ata i mbanin sytë përherë nga horizonti); si një liman i qetë për shpirtin e zhuritur të Ana Marias (ajo gjithë kohës qëndronte mbi një shkëmb dhe herë dëgjonte valët e detit, herë fliste me të, duke i rrëfyer të fshehtat e saj) dhe njëkohësisht si varr për të (duke qenë se aty ajo gjen vdekjen); si lindje e marrëdhënieve vëllazërore (këtu i referohemi episodit të mbërritjes së anijes sovjetike që solli grurë për popullin shqiptar). Pra, deti përfaqëson një simbolikë shumanëshe.

Shkëmbi Ana-Maria ulej në një shkëmb prej nga shihte detin. Në roman shkëmbi përdoret si pikë takimi mes Lekës dhe vajzës, si vendqëndrimi i saj sekret dhe i veçuar. Simboli i tij përfaqëson lartësinë që ndan dy të rinjtë, Ana-Marian dhe Lekën; përfaqë-



son fortësinë e qytetit ku ata ndodhen, mosdorëzimin e tij.

Hëna

Hëna në të gjitha netët që shfaqet mbushet me rrëfimet dhe sekretet e të pagjumëve. Ajo është dëshmitare e situatave të ndryshme.

Kënga

Kënga ndërfitet herë pas here në roman. Dikush, veshur me këmishë të bardhë (simbol i pastërtisë, dëlirësisë), gjatë natës kur tërë gjindja lëkundet mes gjumit dhe bisedave nën zë, i bie kitarës dhe këndon. I këndon vendlindjes, nostalgjisë, mallit.

Në vend të duartrokitjeve, merr lotët e bashkatdhetarëve dhe pagjumësinë e tyre. Katër herë këngëtari zë vend në vepër.

Hera e parë kur shfaqet këngëtari me kitarë në dorë e këngë në buzë përkon me rrëfimin e të Paemrit. I Paemri po u tregonte shokëve odisenë e tij në Shqipëri.

Hera e dytë kur kënga shfaqet përkon me historinë e Ugo Farinit i cili, njësoj si i Paemri, po tregonte historinë e tij se si e bënë mareshal përpara se të mbërrinte në Shqipëri.

Hera e tretë e këngës lidhet sërish me grupin e të Paemrit, Ugos, Danilos, Xhuzepes. Ajo që vihet re është se gjatë të tria herëve këngëtari i këndon vendit, nënës, mallit për shtëpinë, e kjo shkon paralelisht me ndjenjat e personazheve të lartpërmendura.

Herën e katërt këngëtari e nis këngën në kohën kur Karlo Peroni (Arnaldo Massa) vendos të vrasë Ana-Marian. Këngëtari ka zgjedhur një këngë melankolike, ashtu si netët e kaluara, por kësaj here në lidhje me dashurinë...

Lindja si vazhdim i jetës

Gjatë qëndrimit të italianëve në qytetin e ndërtuar nga ata vetë, ndodhi edhe një ngjarje e shënuar që në vetvete mbart një simbolikë të fortë: lindi një foshnjë.

"Lindi antifashisti i parë i qytetit tonë!"

Ardhja në jetë e një fëmije është gëzim, mrekulli dhe gjithçka e bukur. Lindja e një individi është vazhdimësi. Autori përshkruan bisedat për vënien e emrit të bebes.

Dhe çdo emër i zgjedhur prej njerëzve simbolizonte diçka: Italo (në nder të vendlindjes që prisnin ta shihnin së shpejti; mund të hamendësojmë një besëtytni në këtë rast, duke i vënë emrin Italo mund të mendonin se vaporët do vinin më shpejt, se foshnja do i ndillte); Albano (në

nder të popullit shqiptar, Albanez, Alban); Ulise (Odisea në gjuhën italiane quhet Ulise); Shpëtim (një popull i shpëtuar nga fashizmi, nga e keqja); Gëzim (një popull që e sheh rikthimin me gëzim, gëzim që gjithçka mbaroi etj.); Paqësor (nga këtej e tutje populli dëshironte të ishte paqësor, jo më luftëra); Jetim (një popull i mbetur jetim, pa udhëheqje, pa dikë që t'i drejttojë); Ricordi (Kujtim/ e në lidhje me kujtimet që bartin të gjithë); Dimentichi (Harrim, për të harruar gjithçka që kaluan); si përfundim, emrin ia vunë Kalvar në kujtim të kalvarit të popullit italian.

Martesa

Një çift të moshuarish, Filiberto dhe Rodolfina, martohen gjatë qëndrimit të tyre në portin e Durrësit. Një mekanik dhe një soprano e famshme. Një dashuri e rinisë, por që asokohe nuk u ngjiz, u kurorëzua me martesë në pleqëri, në kushte jo fort të përshatshme. Autori e përdor martesën për të treguar jo më vazhdimësi si në rastin e lindjes, pasi çifti është i moshuar, por për të treguar bashkimin dhe forcën e dashurisë kudo dhe kurdo.

Nga sa vërehet, libri është i mbushur fund e krye me simbole. Simbole që orientojnë, simbole që zbukurojnë situata, që sjellin karaktere të veçanta në vëmendjen e lexuesit. Libri mbyllet me largimin e italianëve drejt atdheut të tyre. Edhe njëherë autori nuk lë pa rrëfyer dramën njerëzore. Një popull që kthehet në atdhe i sflitur, i humbur, pa kurgjë. Ana-Maria hidhet në det e mbytet, Lekë Gurra mbetet në breg me cigare të rënë përtokë. Drama qëndron në fatin e mëtejshëm të personazheve. Me përjashtim të Ana-Marias që zgjodhi vetëvrasjen, rrugën më të lehtë, pjesa tjetër e personazheve vazhdojnë të jetojnë dramën e tyre./Exlibris



E rrallë

Shumë peshkaqenë u afruan papritmas pranë një bregdeti në Zelandë të Re



Nëpërmjet pamjeve nga droni janë parë shumë peshkaqenë që u afruan papritmas, pranë një bregdeti në Zelandë të Re, derisa në plazh kishte mjaft turistë. Afrimin e

grupit të dhjetëra peshkaqenëve, e ka vërejtur një zhytës që ndodhej në ujërat e cekëta të Great Barrier Island dhe ka njoftuar autoritetet e sigurisë.


FOTO E DITES



Banorët lokalë në zonën Khanozai në Pakistan shihen duke mbajtur tenxhere me ujë mbi koka. /AFP/

E jashtëzakonshme

NASA "zbulon" asteroidin prej floriri, i cili do ta bëjë çdo njeri në tokë milioner



Nasa ia ka vënë syrin një asteroidi jo shumë larg nesh, i cili, siç thotë shtypi britanik, ka mjaftueshëm flori sa për ta bërë çdo njeri në tokë milioner. Psyche 16 ndodhet mes orbitave të Marsit dhe Jupiterit dhe përbëhet nga metal i ngurtë. Pjesa dërrmuese është ar, por objekti misterioz është i

ngarkuar edhe me platin, hekur e nikel. Në total vlerësohet se metalet e Psyche arrijnë vlerën 8,000 quadrilionë paundë. Që do të thotë se nëse do ta merrim në tokë, do t'i dërrmonte çmimet dhe do ta çonte drejt kolapsit ekonominë botërore me vlerë 59.5 trilionë paundë.

BARSOLETA E DITËS



Dy miksha me njëra-tjetrën: Mbrëmë zbulova që burri im është një gënjeshtar i paparë. Pse fare ndodhi, pyet miksha. Erdhi vonë në shtëpi dhe, kur e pyeta ku ishte, më tha se ishte me Kadriun. Atëherë, pse të gënjeu? Sepse me Kadriun isha vetë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min
Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj.
Regjia: J.J. Abrams




Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

 <p>DASHI Hëna sot në transit në shenjën e kundërt të Peshores mund ta agravojë martesën dhe marrëdhëniet e gjata, por jo aq sa të shkaktojë krizë.</p>	 <p>DEMI Nuk ka asnjë lajm për shenjën tuaj; duhet të merren parasysh vetëm ndikimet e shenjave të tjera, mundësisht miq.</p>	 <p>BINJAKËT Do të jeni të zënë në punë, veçanërisht nëse ka të bëjë me transportin, tregtinë ose siguron kontakte të vazhdueshme me publikun.</p>	 <p>GAFORRJA Paraja dhe çështjet ligjore mund të jenë shkaqe shqetësuese nëse keni lindur në korrik.</p>	 <p>LUANI Përgjigjja më e mirë është entuziazmi me të cilin shefat dhe kolegët mirëpresin planet tuaja.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Mos merrni vendime të nxituara, reflektoni me qetësi dhe, nëse është e mundur, shtyni biznesin jo urgjent.</p>
 <p>PESHORJA Një takim i papritur do t'ju shqetësojë shumë. Është mirë të lini mënjatë një shpenzim të panevojshëm.</p>	 <p>AKREPI Dita e çrregullt. Pengesat në punë dhe ngjarjet e mundshme të paparashikuara ekonomike nuk duhet të bëjnë që të hiqni dorë nga kryerja e një projekti për të cilin jeni të interesuar shumë.</p>	 <p>SHIGJETARI Marrëdhënie të shkëlqyera shoqërore, mundësi për rritjen e aktivitetit profesional. Nëse keni një histori të bukur dashurie që po ndodh, dorëzoni butësisht.</p>	 <p>BRICJAPI Nëse jeni çift, do të jeni më të vëmendshëm se zakonisht për nevojat e të dashurit tuaj. Nëse jeni beqar, një takim do të sjellë dridhura të mëdha në jetën tuaj.</p>	 <p>UJORI Ju mund të udhëtoni, të jetoni situata intensive në vende plot sharmë. Me të dashurin tuaj mund të përjetoni momente me shumë pasion.</p>	 <p>PESHQIT Në përgjithësi jeni dinamik, por nëse nuk kontrolloni tendencën për ekstravagancë, do t'i paguani pasojat.</p>

Jennifer Lopez dëshiron të jetojë në Itali



Aktorja e njohur Jennifer Lopez ka thënë se dëshiron të ketë një jetë më të thjeshtë. Ajo në një intervistë për "Vanity Fair" ka thënë se do të shpërngulej për të jetuar në qytetin Bali të Italisë. "Një jetë tjetër, ku është pak më e

thjeshtë dhe më organike dhe ku mund të ngas një biçikletë, të blej bukë dhe pastaj të shkoj në shtëpi dhe të ulem në një karrige lëkundëse me një pamje më ndryshe. Kam fantazira si kjo", ka thënë Lopez.

Vanessa Hudgens bën paraqitjen e parë publike nga ndarja me Austin Butlerin



Aktorja e njohur Vanessa Hudgens është ndarë nga i dashuri i saj Austin Butler, pas tetë vjetësh. Menjëherë pas ndarjes, aktorja pati paraqitjen e parë publike në Los Angeles me premierën e

filmit Bad Boys for Life. Ajo ishte bashkë me aktorët kryesorë të filmit Will Smith dhe Martin Lawrence. Vanessa shkëlqente me një fustan të bardhë që kishte të veshur dhe nuk dha asnjë intervistë për mediat.



Cardi B synon të bëhet pjesë e qeverisjes në ShBA

Reperja e njohur Cardi B mund të jetë shumë shpejt një politikane. 27-vjeçarja përmes një postimi në "Twitter" ka treguar se do të jetë pjesë e politikës në Amerikë. "Mendoj se dua të bëhem politikane. Unë

me të vërtetë e dua qeverinë, edhe pse nuk jam dakord me qeverinë", ka shkruar ajo. A po përgatit Cardi B një karrierë në politikë? Në fakt, duket se e ardhmja e saj do të lidhet ngushtë me politikën.

Jonas Hilli e konfirmon bashkëpunimin me Adidas

Aktori i njohur Jonah Hill e ka konfirmuar përfundimisht bashkëpunimin e tij me markën e njohur të rrobave "Adidas". Aktori i "Wolf of Wall Street" me anë të një postimi në rrjetin social "Instagram" ka thënë e kjo ka qenë

një ëndërr e tij e kamotshme. "Faleminderit 'Adidas' që më besove në idetë e mia dhe i shtyni ato të bëhen edhe më të mira. Kjo është një ëndërr për mua që ta filloj udhëtimin e krijimit me një ekip që e respektoj dhe e dua", ka shkruar Hilli.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT Pilkington
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Volkswagen: Kosova, përralla e madhe e një vendi të vogël



PRISHTINË, 16 JANAR - Faqja zyrtare e kompanisë Volkswagen që ka qenë përkrahëse e futbollit gjatë vitit të fundit, si partnere e Federatës së Futbollit të Gjermanisë dhe ekipit kombëtar të Gjermanisë, e ka publikuar një artikull të veçantë për arritjet e ekipit përfaqësues të Kosovës. "Kosova ka qenë anëtare e UEFA-s vetëm për tre vjet. Tani i duhen vetëm dy fitore dhe vendi i vogël i Ballkanit do të jetë i kualifikuar për Kampionatin Evropian 2020. Por, deri te kjo ngjarje përrallore ata e kanë pasur një rrugë të vështirë", shkruan Volkswagen. Më 3 maj të vitit 2016 tentimet diplomatike të Kosovës u shpërblyen. Aplikimi për anëtarësim ishte 300 faqe i gjatë dhe Kosova u pranua si anëtarja e 55-të në Kongresin e UEFA-s në Budapest. Me 28 vota për, 24 kundër dhe dy abstenime, rezultati ishte i afërt, por kjo s'ë ndikoi festën: Delegacioni kosovar dhe gazetarët që kishin udhëtuar me ta u përqafuan, duke u rrjedhur lotët. "Ishte shumë emocionale", kujton sekretari i përgjithshëm i Federatës së Futbollit të Kosovës, Eroll Salihu. Që nga atëherë, në vendin e vogël ballkanik, me vetëm rreth 1.8 milion banorë, ka pasur një eufori për futbollin. Kur u pranua në UEFA, Kosova nuk e kishte asnjë stadium që i përmbushte kriteret ndërkombëtare. Ndeshjet si vendëse i luante në qytetin e Shkodrës në Shqipëri. Por, pastaj, më në fund u rinovua stadiumi Fadil Vokrri në Prishtinë dhe trajneri Bernard Challandes u emërua selektor. Si rrjedhojë, Kosova e arriti një ecuri prej 15 ndeshjeve radhazi pa disfatë. Në Ligën e Kombeve e fitoi grupin në Ligën D dhe pastaj ishte mbresëlënëse në Grupin A të kualifikimeve për "EURO 2020". "Është e mrekullueshme, i kemi kaluar të gjitha pritjet tona", ka shtuar Salihu. Në fakt, suksesi i kësaj skuadre të re është pothuajse përrallor. Vetëm para 25 vjetëve futboli në Kosovë u takonte ekskluzivisht livadheve dhe arave. Kur Kosova ishte ende

pjesë e Jugosllavisë dhe më vonë Serbisë, shqiptarët e kishin themeluar një lloj shteti paralel: nxënësit mësoheshin në shtëpitë-shkolla, të sëmurët trajtoheshin në klinika të improvizuara dhe futbollistët shqiptarë u larguan nga liga jugosllave në vitin 1991 dhe e filluan ligën e tyre. Goli i parë u shënua më 13 shtator nga Eroll Salihu. Ai më herët kishte luajtur në ligën elitare të Jugosllavisë me Prishtinën, por këtë gol e konsideron "një moment historik" në karrierën e tij. Megjithatë, kësaj lige alternative ilegale i mungonte gjithçka. Stadiumet zyrtare në Kosovë ishin në duart e Serbisë. Por, përkundër që ndeshjet zhvilloheshin nëpër livadhe, ato shpeshherë ndiqeshin nga mijëra tifozë. Automjetet e ndryshme me të cilat vinin skuadrat shërbenin si zhveshtore. Policia serbe tentonte t'i ndalonte këto ndeshje, duke i arrestuar ata që merrnin pjesë. Por, Federata e Futbollit të Kosovës, që ende s'ishte zyrtarisht e njohur, vazhdon të organizonte ndeshje deri kur filloi lufta në vitin 1998, që përfundoi një vit më vonë falë intervenimit të NATO-s. Eroll Salihu veçse ishte shpërngulur në Gjermani, ku luajti për Wilhelmshaven në ligën regjionale dhe e mori licencën e trajnerit. Ai u kthye pas pesë vjetëve. "Kosova është vendi im", thotë ai. Kosova veçse e kishte një ekip kombëtar atëherë, por nuk kishte kundërshtarë me të cilët mund të luante. Në nivelin ndërkombëtar vendi që ishte nën administratën e Kombeve të Bashkuara ishte i izoluar. Kjo situatë nuk ndryshoi as pasi Kosova e shpalli pavarësinë në vitin 2008. Serbia vazhdon ta konsiderojë Kosovën provincë të veten të ndarë dhe e ka mbështetur për këtë nga Rusia. Pesë vende të BE-së - Spanja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Qipro - ende s'ë kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Deri vonë, edhe vetë popullsia e Kosovës s'ishte e lidhur me ekipin e vet kombëtar, pasi që ata e mbështetnin ekipin kombëtar të Shqipërisë. Në vitin

2006 Salihu u bë sekretari i përgjithshëm i Federatës së Futbollit të Kosovës. Sfidat me të cilat u përball në ato kohë ishin të mëdha: nuk kishte para, infrastrukturë, ndeshje apo ekipe konkurruese. Një gjeneratë e plotë ishte humbur në Kosovë shkaku i situatës në vitet e '90, që është arsyeja pse lojtarët filluan të mblidheshin nga vendet evropiane perëndimore. Një gjeneratë e re e talentuar u gjet në ligat gjermane, zvicerane, belge e norvegjeze - ku luanin fëmijët e refugjatëve kosovarë. Disa prej tyre kishin luajtur për grupmoshat e vendeve ku jetonin, por pastaj e ndryshuan Kombëtares dhe iu bashkuan Kosovës. "Ne nuk patëm nevojë t'i bëjmë presion askujt", theksoi Salihu. Nuk u pajtuan të gjithë ta bëjnë këtë ndryshim, por në fund ishte e mjaftueshme. Kur erdhi suksesi, kosovarët e zbuluan papritmas dashurinë e tyre për ekipin e vet kombëtar. Për Salihun, problemi më i madh është se si të zgjidhet problemi me kërkesat e mëdha për bileta. Kur Anglia e vizitoi Kosovën në nëntor të vitit të kaluar, 135 mijë njerëz dëshiruan ta shikojnë ndeshjen në stadiumin ku janë vetëm 13 mijë ulëse. Edhe pse Kosova s'u kualifikua përmes Grupit A në EURO 2020, këtë mund ta arrijë përmes "play-off"-it. Në mars, hapi i parë për Kosovën drejt EURO 2020 do të jetë në gjysmëfinalen kundër Maqedonisë Veriore, ndërsa në finale mund t'i presë Bjellorusia ose Gjeorgjia. "S'mund ta imagjinoj çfarë mund të ndodhë. Vendi do të përmbysë", thotë Salihu. Eroll Salihu shpreson që suksesi sportiv do t'i ndihmojë Kosovës të marrë njohje zyrtare nga vende të tjera. "Ne jemi pjesë e Evropës dhe duam të jemi të barabartë", ka thënë sekretari i përgjithshëm, duke e ditur se kjo gjë mbetet në dyshim vetëm në politikë. Bota e futbollit s'ka nevojë të bindet pas paraqitjeve të Kombëtares së Kosovës. Sa i përket futbollit, Kosova ka arritur në Evropë.

SHKURT

Kupa "Nënë Tereza" bën jehonë në mediat e huaja, pritet përgjigjja nga UEFA

Shqipëria dhe Kosova kanë nisur hapat e parë të bashkimit nëpërmjet sportit me anë të krijimit të Kupës "Nënë Tereza". Në këtë kompeticion do të marrin pjesë klube nga të dyja vendet, ndërsa është kërkuar në UEFA që fituesi të ketë mundësinë e pjesëmarrjes në kupat evropiane. Një gjë e tillë ka marrë jehonë të madhe edhe në mediat e huaja, të cilat kanë nisur të flasin mbi këtë temë. Zyrtarët e futbollit në Shqipëri dhe në Kosovë kanë kërkuar mbështetje qeveritare, për sigurim të vlerës monetare që do t'u shpërndahet ekipeve, ndërsa mediat e huaja, duke nisur nga Franca, Italia, Spanja apo Anglia, tregojnë se e vetmja gjë që tani pritet është përgjigjja nga UEFA, pasi çdo gjë tjetër është gati për t'u jetësuar.

Ajzeraj rikthehet në Kosovë, nënshkruan për Dritën

Skuadra e Ditës nga Gjilani e ka transferuar futbollistin e talentuar Almir Ajzeraj. Ajzeraj edicionin e kaluar ishte pjesë e skuadrës së Skënderbeut të Korçës, kurse ka qenë pjesë edhe e Përfaqësueses së Kosovës. "Ajzeraj ka nënshkruar kontratë për dy vjet e gjysmë dhe do të jetë një ndihmesë e madhe për klubin tonë drejt qëllimeve tona. Ajzeraj më parë ka qenë pjesë e Kosovës U21 dhe e klubeve si Flamurtari dhe Ballkani, kurse së fundmi ka qenë pjesë e Skënderbeut të Korçës", thuhet në njoftimin e Dritës.

Të shtunën grumbullohen U18-shat

Përfaqësuesja e Kosovës U18 në konkurrencën e meshkujve do të grumbullohet të shtunën në Prishtinë, që do të jetë grumbullimi i parë për këtë vit për këtë grupmoshë. Më herët janë grumbulluar Kosova U16 dhe U20 në të dyja konkurrencat. Grumbullimi i Kosovës U18 do të bëhet të shtunën në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë, ku lojtarët do të ndahen në dy grupe. Grupi i parë do të bëjë stërvitje nga ora 13:00-15:00, kurse grupi i dytë 15:00-17:00. Përzgjedhësi i Kosovës U18 (M), Bekim Maxhuni, ka shpallur listën e gjerë, ku lojtarët do të jenë të ndarë në dy grupe, kurse gjithashtu janë ftuar edhe lojtarë që luajnë në ShBA dhe Evropë. Kosova U18 do të garojë në FIBA U18 Kampionatin Evropian, Divizioni B, që do të mbahet në Oradea të Rumanisë prej 24 korrikut deri më 2 gusht 2020. Kosova U18 (M) do të jetë në Grupin D me Maqedoninë Veriore, Suedinë, Danimarkën, Letoninë dhe Bjellorusinë.

Kosova U17 e nis me humbje turneun në Izmir

IZMIR, 16 JANAR - Përfaqësuesja e Kosovës U17 në futboll e ka zhvilluar ndeshjen e parë në kuadër të turneut "Mercedes Benz Aegean Cup International Youth Tournament" në Izmir dhe atë kundër ekipit nikoqir, Turqisë. Pas një loje

interesante dhe me rivalitet të madh në fund fitores iu gëzua Turqia, me rezultat të ngushtë 1-0. Në pjesën e parë ishin vendësit që krijuan më shumë raste para portës së "dardanëve" të rinj, por që mbrojtja ishte në nivelin e duhur.

Ndërkohë, në minutën e 53-të Mahmut Afsar shfrytëzoi një gabim të mbrojtjes së Kosovës dhe realizoi nga brendësia e zonës për zhblokimin e rezultatit, që në fund doli të jetë edhe goli i vetëm në ndeshje. Pas pësimit të golit djelmshat e

Besnik Kollarit ishin më këmbëngulës drejt portës turke për ta gjetur golin e barazimit, por me gjithë rastet e krijuara nuk ia dolën t'i ndryshojnë shifrat e ndeshjes. Ndeshjen e radhës Kosova e zhvillon kundër Tanzanisë më 17 janar.



U dorëzuan stemat e FIFA-s për 13 gjyqtarë

PRISHTINË, 16 JANAR - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, sekretari i përgjithshëm Eroll Salihu dhe kryetari i Komisionit të Gjyqtarëve, Përparim Hasani, të enjten kanë dorëzuar stemat e reja të FIFA-s për 13 gjyqtarë. Paraqitjet e mira të dy tresheve të deritashme të gjyqtarëve në



Gjyqtarë kryesorë:
Genc Nuza
Besfort Kasumi
Visar Kastrati

Asistentë:
Fatlum Berisha
Bujar Selimaj
Fatmir Sekiraga
Edmond Zeqiri
Imran Kabashi
Besnik Morina

Gjyqtarë të futsallit:
Besar Beqiri
Besart Ismajli
Ekrem Franca

Asistente (futbolli i femrave)
Lumturije Muhadri

arenën ndërkombëtare në krye me Genc Nuzën e Besfort Kasumin kanë bërë që krahas rikonfirmimit të tyre me stemën e FIFA-s, sivjet me stemën e FIFA-s të pajiset edhe një treshe tjetër e gjyqtarëve në krye me Visar Kastratin. Sivjet me stemën e FIFA-s janë pajisur tre gjyqtarë kryesorë, gjashtë asistentë, tre gjyqtarë të futsallit dhe një asistente në futbollin e femrave. Kryetari i FFK-së, Agim Ademi, ka përgëzuar gjyqtarët për pajisjen me stemën e FIFA-s, duke vlerësuar si tejet të rëndësishëm rolin e tyre në zhvillimin e garave vendore, por edhe në imazhin që ata

po i japin futbollit tonë në ndeshjet ndërkombëtare. Ai ka kërkuar vendosmëri dhe profesionalizëm edhe më të madh në këtë vit, në mënyrë që t'i ndihmojnë edhe gjeneratat e ardhshme për t'u pajisur me stemën e FIFA-s dhe për të pasur mundësi shijimit e ndarjes së drejtësisë në ndeshjet ndërkombëtare. Edhe sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu, ka kërkuar nga gjyqtarët përfitues të stemave të FIFA-s vigjilencë dhe punë sa më profesionale në vazhdim, duke mos rënë asnjëherë pre e presioneve të mundshme apo dukurive të ndryshme negative.

Lakersat befasohen nga Orlando

LOS ANGELES, 16 JANAR - Skuadra e Orlandos i ka befasuar Lakersat, duke triumfuar me rezultat 119-118 në Los Angeles, një rezultat surprizë. Mungesa e Davisit ndikoi te skuadra kaliforniane, ku u dalluan Cook me 22 pikë e James me 19 pikë e 19 rebounde. Për Orlandon shkëlqeu Fultz, që realizoi një "triple double", me 21 pikë, 11 rebounde e 10 asistime, por 21 pikë realizoi edhe Gordoni. Humbja e dytë radhazi për Houstonin, që u mund 117-107 nga Portlandi, ndeshje e dominuar nga miqtë. Westbrook realizoi një "triple double", me 31 pikë 11 rebounde



e 12 asistime, por që mbetën për statistikë. Lillardit me 25 pikë e McCollum me 24 bënë diferencën për Orlandon. Këto humbje favorizojnë Denverin në Perëndim, që fitoi rezultat 100-86 ndaj Charlottes dhe i afrohet kreut. Diferencën e bënë lojtarët e stolit të Denverit që realizuan 50 pikë. Jashtë fushe skuadra e Torontos mundi 130-121 Oklahoman, në një ndeshje spektakolare, të dominuar nga kanadezët. Të gjithë titullarët e

Torontos realizuan mbi 15 pikë, por më i miri ishte Powell me 23 pikë, që e nisi ndeshjen nga stoli, raporton "Telesport". Miami e mposhti me rezultat 106-100 San Antonion, sfidë ku u dallua Nunn me 33 pikë, ndërsa Philadelphia triumfoi 117-106 ndaj Brooklynit (Harris 34 pikë e 10 rebounde). Fiton edhe Dallasi, që mundi 127-123 Sacramenton, me Donqiq që realizoi 25 pikë, 15 rebounde e 17 asistime.

SHKURT

Përforcohet KB Prishtina

Klubi i Basketbollit Prishtina ka konfirmuar marrëveshjen me fundorin amerikan Anthony Goods. Lojtari ishte pjesë e G-League në Amerikë me Santa Cruz Warriors. Aty, sipas Prishtinës, kishte mesatare prej 18 pikësh. Goods ka qenë pjesë edhe e Superligës së Izraelit e karrierë ka pasur edhe në Ukrainë, Poloni e në Francë.

Turku dhe Musa 'aterojnë' në Drenicë

KF Drenica nga Skenderaj ka vazhduar përforcimet në këtë afat kalimtar. Klubi kuqezi është përforcuar me dy mbrojtësit e njohur në futbollin e Kosovës, Edmond Turku dhe Muharrem Musa. "Qendërmbrojtësi i njohur Edmond Turku do të jetë përforcimi i radhës i ekipit tonë. Ky përforcim mbyll hapësirat boshe në qendër të mbrojtjes dhe futbollisti i spikatur ishte kërkesë edhe e trajnerit Sejdiu. Turku ka firmosur kontratë deri në fund të këtij edicioni të garave, me mundësi të vazhdimit pas stinorit pranveror. Ai njihet si një mbrojtës tejet luftarak dhe me përvojë. Ndërkohë, klubi njofton edhe për rikthimin e futbollistit vendor Muharrem Musa. Mbrojtësi anësor është rikthyer në skuadër për pjesën e mbetur të kampionatit. Musa është produkt i Shkollës së Futbollit 'Drenica'", thuhet në njoftimin e Drenicës.

Reali merr Van De Beekun, Pogba shkon te Juve

Real Madridi ka ndjekur me shumë interes që verën e kaluar mesfushorin e Ajaxit të Amsterdemit, Donny van de Beek. Gjigantët spanjollë raportohet se kanë arritur një marrëveshje me "harkëtarët" që mesfushori i Holandës t'i bashkohet në verë klubit mbretëror për 55 milionë euro. Sipas "Tuttosport", ky transferim do t'u hapë rrugë kampionëve të Serisë A për të arritur një marrëveshje me Manchester Unitedin për mesfushorin francez Paul Pogba. Juventusit e ka prej kohësh idenë për të kthyer në Torino kampionin e botës, i cili pikërisht te bardhezinjtë u bë një nga më të mirët në qarkullim.

Messi kërkon nga Barça transferimin e Agueros

Skuadra e Barcelonës është në kërkim të një sulmuesi për sezonin e ri. Portali spanjoll "Diariogol.com" raporton se ylli kryesor i skuadrës, Lionel Messi, ka dhënë preferencën e tij. Messi dëshiron që Barcelona ta transferojë golgeterin e Manchester Cityt, Sergio Aguerro. Por, largimi i Agueros nga Manchester City nuk është aspak i lehtë marrë parasysh faktin se ai është një prej futbollistëve kryesorë në formacionin e Pep Guardiollës.

Xavi: Është herët të bëhem trajner i Barçës

Xavi Hernandez ka pranuar se ka refuzuar ofertën për t'u bërë trajneri i Barcelonës në fillim të kësaj jave pasi, sipas tij, ishte shumë herët. Xavi aktualisht është menaxher i klubit futbollistik nga Katari, Al Sadd, të cilin e mori në dorë majin e kaluar dhe është nën kontratë deri në verën e vitit 2021. Drejtori sportiv i Barcelonës, Eric Abidal dhe drejtori Oscar Grau u takuan me ish-mesfushorin qendror në Katar të premten e kaluar, ku ata i bënë ofertë Xavit për drejtimin e klubit. Kjo ofertë ishte kur Ernesto Valverde ishte akoma në pozitën e trajnerit, por shkarkimi i tij u konfirmua të hënën pas humbjes në Supekupën e Spanjës kundër Atletico Madridit. Quique Setien u emërua trajneri i ri i Barçës këtë javë. "Po, unë mora një ofertë nga Barcelona në një takim me Eric Abidal dhe Oscar Grau, por nuk e pranova. Refuzimi erdhi veçanërisht sepse është shumë herët për ta trajnuar Barcelonën, por do të mbetet ëndrra ime në të ardhmen të jem një trajner i Barçës", ka thënë Xavi. "Së pari i tregova familjes sime dhe pastaj lojtarëve të Al Sadd sepse ata ndoqën çështjen. Për tri ditë nuk isha në pozicionin tim më të mirë, por tani jam tërësisht i përqendruar në Al Sadd", ka shtuar Xavi.

REZULTATET

Boston - Detroit	103-116
Philadelphia - Brooklyn	117-106
Miami - San Antonio	106-100
Chicago - Washington	115-106
Minnesota - Indiana	99-104
Oklahoma - Toronto	121-130
Denver - Charlotte	100-86
Houston - Portland	107-117
Sacramento - Dallas	123-127
Lakers - Orlando	118-119



					Autor: GAZMEND MORINA	KËNGËTARJA JONË LILA	BYREKU ME LAKRA TË GRIRA	VEGËL MUZIKOR, BORI	LLOJ PAPAGALLI	SILIC	NJËSIA PËR MATJEN E FUQISË SË RRYMËS ELEKTRIKE	LUMË NË SHBA E KANADA ME UJËVARA ATRAKTIVE	INTER	EPOKA ERE	BASHKË, ME (bised.)	MIMOZA MUSTAFA				
					QYTET NË SHQIPËRI											TIM MONTGOMERI NË KËTË MOMENT				
					DHËNIA E NJË ÇMIMI TË LARTË												AKTORI ... HANKS FUTBOLLISTI SPANJOLL SERGIO			
					KRIMB TOKE QË VIHET NË MAJË TË GREPIT PËR TË NDJELLË PESHKUN								PRIMITIV FSHATI KU NDODHET AEROPORTI I TIRANËS				◯		MODEJA & AKTORJA E FAMSHME PARAGUAJANE RIQUELME	
					DUKATI								ISH PRESIDENTI AMERIKAN RONALD BASHKËT.				◯		BASHKËT. DIÇKA QË BURON NGA DIÇKA TJETËR	
					EPOKA ERE		ZANORE EMËR MASHKULLI MYSLIMAN					TRUP GJEOMETRIK USHTRIA						◯		
LLOJ PAPAGALLI								AKTORI I FAMSHËM ROBERT I AFROVA (bised.)					◯	EMI ROSUM PASURITË E PATUNDSHME QË SILLNIN TË ARDHURA (vjet.)						
KLUB I YNI FUTBOLLI										SHTET I LASHTË NË AZI (pashq.) ZANORE			◯							
EPOKA ERE	SHPËRTHIM I FUQISHËM	SHKENCA MBI PAQEN	ISH FUTBOLLISTI KROAT KOVAÇ (BAYERN MUNICH)	↓	FUTBOLLISTI GRANIT BRITMË E LOPËS	ILIRIDA ZANORE	VËLLIMI, SASIA TENISTJA JUSTINE					EMOCIONOH- EM; MË LË MBRESA DIÇKA; MALLËNGJ- EHM	RADIOLOGY INFORMATION SYSTEM LËRE (bised.)							
MAKINË QË SHNDËRRON ENERGJINË MEKANIKE NË ENERGJI ELEKTRIKE															FUTBOLLISTI MARTINEZ (B. MUNICH) FLETORË PËR SHËNIME DITORE	QYTET SHQIPTAR NË MAL TË ZI PËRGJIGJE NË TELEFON				
KITARISTI I FAMSHËM KLEPTON (shq.)							HAPËSIRË E MADHE UJI (shq.) TËRËSIA E NJOHURIVE TË FITUARA; DJE									KËNGËTARJA E FAMSHME FRANKLIN AVULL QË DEL NGA TOKA	ISH KËNGËTARJA BITRI			
QYTET I SHENJËTË I MYSLIMANËVE						FUTBOLLISTI ANTONIO (UDINESE) FUTBOLLISTI YNË FREDERIK (MAN. UTD.)											SHKRONJË GREKE ANNA MICHELLE			
"N" në mes të dy "O"					QYTET NË KOSOVË (pashq.) PUNË A VEPËR MIZORE; KËRDI												JURIST QË JEP NDIHMË PËR ÇËSHITJE TË DREJTËSISË I ÇEL	BASHKËT. LIGJI, KANUNI (vjet.)		
SËMUNDE E RËNDË NGJITËSE (pashq.)			GAZ NATYROR I THJESHËTË, PA NGJYRË E PA ERË (shq.) SHTET NË EVROPË							ZANORE FUTBOLLISTI MEHA (shq.)		ERMELINDA MEKSI PRINC ARAB					NORA ISTREFI KËNGËTARI ARIFI (shq.)			
I ÇMENDUR, I TRANUAR								BANESË E VEÇANTË E GRAVE TË SHEIKËVE GRYKA E VULLKANIT									NË DITËN E SOTMË I GJALLË E I SHKATHËT; ENERGJIK			
PUSHKË E GJATË ME PESË FISHEKË							LAPS						FIGURË SHAHU GJAKËS							
EPOKA ERE	ANËTARËSIM NË NJË ORGANIZATË	PJESË E LIMANIT SËMUNDJA E TUBERKUL- OZIT					RANCHO PENASQUITOS BASKETBALL KËNGËTARJA MERITA				JETA E QETË DHE E LUMTUR (libr.) GROSETO, IVREA							FABRIKË E MEKANIZUAR (sh.shq.)		
DËNTIM I NJË MAKINE GJATË KOHËS SË PUNËS OSE GJATË LËVIZJES						KAPËRDIJ ISH PIKTORI SHQIPTAR CAPO												ZANORE VENDLINDJA E ODISEUT		
KËNGËTARJA AUSTRALIANE MINOGUE (shqip.)						DJALLI (hebr.) KAFSHË E VOGËL SHTËPIAKE												SHKRIMTARI KELMENDI SHTET NË AZI (pashq.)		
ERBIUM, INTENSITET					BOJAXHIU SOCIETY ECONOMIC DYNAMICS													KONFERENCË ME KARAKTER NDËRKOMB- ËTAR (shq.) KORNIZË		
VSPANËSIRË			IRONIA E HIDHUR DY BASHKË- TINGËLLORE																DUKURI E RE DY BASHKË- TINGËLLORE	NYJË ALFRED KAÇINARI
IDIOTI, DEBILI																			KAP DIÇKA TE PJESA E SIPËRME NË NJË GOZHDË ANTALYA	FUTBOLLIST I NJOHUR BRAZILIAN (R. MADRID) BASHKËT.
DYSHEK I MBUSHUR ME KASHTË QË SHTROHET PRANË VAT- RËS (shq.)																			KUNDËRSH- TAR I PËRBETUAR	SECILA NGA PJESËT E NJË NDËRTESE, QË NGRIHEN NJËRA MBI TJETRËN



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



KOMUNA JUNIK
Dt.17.01.2020

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, neni 17, Në bazë të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës nenet 7 dhe 8, Ligjit mbi Arsimin Para universitar të Republikës së Kosovës nr 04/L-032, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr 10/2018, për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ të MPMS – nr 07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Komuna Junik shpallë këtë shpallë:

KONKURS

Për plotësim e vendit të lirë të punës për vitin shkollor 2019/2020

Shkolla fillore e mesme e ulët "Edmond Hoxha" në Junik

Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e Gjuhës Angleze 12 orë, në javë.

Gjinnazi "Kuvendi i Junikut në Junik

Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Biologji për 20 orë, deri të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë.

KUSHTET:

- Për vendin e lirë të punës për mësimdhënës/e kërkohet përgatitja profesionale përkatëse,
- Në mungesë të kuadrit të kualifikuar vijnë në konsiderim kandidatët me kualifikim të përafërt.

DOKUMENTACIONI I KËRKUAR:

- Diploma (çertifikata) në origjinal ose fotokopje e vërtetuar nga organi përkatës,
- Çertifikata e lindjes,
- Letërnjoftimi i fotokopjuar,
- Dëshmi për përvojën e punës,
- Dëshmi për trajnimet arsimore,
- Çertifikata e shtetësisë,
- Çertifikata nga Gjykata që nuk jeni nën hetime,
- Vërtetim nga zyra e Punësimit,
- Aplikacioni tërhiqet dhe dorëzohet në Zyrën e pritjes në Junik,
- Dokumentacioni i pakompletuar si dhe ato pas afatit nuk merren në shqyrtim,
- Afati i konkurimit është 15 ditë nga data e shpalljes në gazetën ditore,
- Për ditën e intervistimit, kandidatët do të njoftohen me kohë përmes telefonit.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA
K.R.M. "ÇABRATI"

Tel: +381(0)390/321 588
+381(0)390/324 034
www.cabrati.com
e-mail: info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakova

KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE "ÇABRATI" SH.A. GJAKOVË, në përputhje gjenden momentale dhe nevojave e kompanisë për plotësim të vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare bazuar në Vendimin e Kryeshefi Ekzekutiv Nr.81 të datës 15.01.2020, vendosi që me datë 16.01.2020 të shpallë:

Konkurs publik

Për këtë pozitë, si vijon:

3 /tre/ Punëtor fizik me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një/ vjeçare), me mundësi vazhdimi,

Kushtet:

- Të posedojnë aftësi fizike dhe shëndetësore për punë me ngarkesë fizike, përshtatshmeri për punë në ambiente të jashtme dhe zbatim të urdhërave të punës,
- Preferohet të ketë shkollim fillor,
- Dëshminë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime (më e re se 6 muaj).
- Të posedoi letër njoftim apo certifikatë lindjes.

Kushtet e veçanta: Punëtori 6 / gjashtë/ muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo ndërpritet kontrata e punës.

Detyrat:

- Kryen punët e ngarkimit dhe shkarkimit të bërllokut dhe mbeturinave tjera në/ nga automjete speciale dhe traktor, kontejner etj., shtëpi në shtëpi në territorin e Komunës së Gjakovës dhe jashtë;
- Kryen punët e pastrimit, larjes dhe spërkatjes e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve, pastrimit të lumenjve, parqeve, pastrimin e puseve dhe pusëve të kanalizimeve fekale dhe atmosferike, dhe
- Kryen edhe të gjitha punët fizike tjera të natyrës së ngjashme të cilat përcaktohen nga udhëheqësit e tij të drejtpërdrejt, apo veprimtaria e ndërmarrjes të rangut të njëjtë të kategorizuar dhe sistemuar si vend i ngjashëm i punës.

Dokumentet: Të posedoj:

- 1 Kërkesën me CV-i;
- 2 Dëftesën mbi kryerjen e shkollës fillore;
- 3 Certifikatën e lindjes apo Letër Njoftimit;
- 4 Dëshminë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime (më e re se 6 muaj).

Afati i paraqitjes së kërkesave është 15 ditë nga dita e publikimit, (nga data 16.01.2020 e deri me datë 30.01.2020 më së largu deri në orën 16:00).

Kërkesën me dokumentacionin e kërkuara, kandidatët duhet t'i dorëzojnë në drejtorin e KRM. "Çabrati" SH.A. në Gjakovë, Rr. "Mazllom Lakuci" pn. (tek Udh. Burimeve Njerëzore). Dokumentet pa afat dhe të pakompletuara nuk do të merren për bazë. Pas kalimit të afatit të konkursit, kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit publik i nënshtrohen procedurave të përzgjedhjes.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Ibrahim Maxhuni shpall të pavlefshme diplomën e Gjinnazit "Xhevdet Doda" në Prishtinë.

► Ilaz Zena shpall të pavlefshme dëftesën e SHF nga I deri VIII "Emin Duraku" Likoc.

► Salim Curri Shpalle te pavlefshme diplomën e Sh.M.L "Dardania" Hani Elezit.

► Zemile Berisha shpalle te pavlefshme dëftesën e Kl 1-8 Shkolla Fillore "Veli Ballazhi" Hani Elezit.

► Fatmire Cecelia shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Xheladin Deda" - Mitrovicë.

► Jetmir Ramadani shpall të pavlefshme dëftesën e SHF "Dëshmorët e Qyqavicës" Qirez.

► Ardian Halili shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së dhjetë, njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë si dhe diplomën dhe certifikatën e shkollës së mesme "Gjin Gazulli" Prishtinë.

► Shkëlzen Llugaliu shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së dhjetë, njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, trembëdhjetë si dhe diplomën e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.
Tel. 044-413-197.



Kolegji ILIRIA në Prishtinë, me rastin e shënimit të **552-vjetorit** të vdekjes së heroit kombëtar shqiptar **Gjergj Kastrioti Skënderbeu**, organizon simpoziumin shkencor me titull:

**GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU
NË DOKUMENTE TË PANJOHURA ARKIVORE
TË VENDEVE TË HUAJA**

SIMPOZIUM SHKENCOR

**FTESË PËR SIMPOZIUM SHKENCOR,
GJERGJ KASTRIOTI -SKENDERBEU, NË GRAND
HOTEL NË PRISHTINË MË 17 JANAR 2020 ORA
12.00 SALLA SOLEMNE-KATI I PARË!
ORGANIZUAR NGA KOLEGJI "ILIRIA" NË SHËNIM
TË 552 VJETORIT TË VDEKJËS SË TIJ!**

Simpoziumi do të mbahet më
17 janar 2020
në sallën solemne të
"Grand Hotel"-it në Prishtinë,
Kati I, në orën 12.00